



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
Agencija za Razvoj Poloprivrede
Agriculture Development Agency

Raporti

Vjetor i Punës për Vitin 2021



Hyrja

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-090 për ndryshim plotësimin e Ligjit me nr. 03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Rregullores 01/2012 për Detyrat, Përgjegjësit, Kompetencat dhe strukturën Organizative të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ku është përgjegjëse për implementimin e programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke zbatuar rregulloret dhe procedurat e shkruara për implementimin e Pagesave Direkte dhe Projekteve për Zhvillim Rural.

Organizimi i AZHB-së është përcaktuar me Rregulloren nr. 01/2012 për detyrat, përgjegjësitë, kompetencat dhe strukturën organizative të agjencisë për zhvillimin e bujqësisë.

Raporti Vjetor nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është një prej dokumenteve më të rëndësishme për agjencinë. AZHB-ja e sheh të rëndësishme nevojën për të informuar lexuesit e interesuar lidhur me reformat, iniciativat, aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2021, ju do të informoheni rreth të gjitha të dhënave relevante që janë gjeneruar ose grumbulluar nga drejtorit përkatëse në AZHB, të dhëna të cilat dëshmojnë zhvillimin e shpejtë të sektorit bujqësor në Kosovë. Pa dyshim se duke parë potencialin që ka ky sektor, ende nuk kemi arritur aty ku ne e kemi synim. Ne do të rrisim në vazhdimësi përkrahjen, në veçanti duke u fokusuar në ato kulturat që sjellin vlera më të larta, por edhe në diversifikimin e aktiviteteve në ferma.

Treguesit e bilancit tregtar flasin për dominim të madh të prodhimeve të importit në tregun bujqësor të Kosovës. Posaçërisht problematikë për gjendjen e sektorit të bujqësisë përbën fakti i përballjes me një konkurrencë të ashpër nga importi, dhe pa ndihmën e duhur të shtetit dhe fondeve të BE-së, donatoreve të tjerë, vështirë se mund të ketë kushte të favorshme dhe konkurruese për fermerët në Kosovë. Megjithatë, bujqësia në Kosovë, vazhdon të jetë një nga degët më të rëndësishme dhe më premtuese për përmirësimin e treguesve makro-ekonomik.

Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit, konsiston në kushtet e favorshme që ka Kosova për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht disa sektorëve të saj. Kosova ka një popullsi relativisht të re, Bujqësia e Kosovës pra është sektor në konsolidim i cili do të ndikoj në përmirësimin e kualitetit të jetesës në vendbanimet rurale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Duke e ditur këtë fakt Qeveria e Republikës së Kosovës përkahtësisht MBPZHR-ja ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut dhe ka qenë e vendosur që përmes granteve për zhvillim rural dhe Pagesave direkte të mbështet fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare. Gjithsesi në vazhdim na presin shumë sfida të cilat i kemi paraqitur në këtë raport, që së bashku me ekspertët, investitorët dhe partnerët tanë përmes strategjive të ndryshme, do të mundohemi që të zbusim këto sfida dhe të arrijmë rezultate pozitive. Raporti Vjetor është përgatitur duke bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë nga AZHB-ja, MBPZHR-ja, dhe agjenci të tjera. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm të bujqësisë dhe të bëjmë përpjekje që ky sektor të jetë më i suksesshmi në të ardhmën drejtë zhvillimit ekonomik të Kosovës. Fokusi ynë kryesor është respektimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore, vlerësimi i drejtë dhe i pa anshëm, transparenca, ofrimi i shërbimeve më të mira për farmer, kompani dhe agrobiznese.

Përmbajtja

Hyrja	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	8
Sektori i Personelit	8
Sektori i Logjistikës	11
Sektori Ligjor	13
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	15
Drejtoria i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural.....	16
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore.....	16
Objektivat e përgjithshme	16
Masa 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore’’	17
Objektivat e përgjithshme	17
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve 2020 -21.....	19
Objektivat e përgjithshme	19
Masa për ujitjen e tokave bujqësore.....	20
Objektivat e përgjithshme	20
Procedurat e zbatimit të Projekteve të Zhvillimit Rural	22
Aplikimi / Thirrja e dytë PZHR 2020/21	26
Shqyrtimi administrativë, vlerësimi, kontrolli në terren dhe Miratimi i Projekteve të Zhvillimit Rural.....	28
Disa nga veshtrësit e hasura gjatë zbatimit të PZHR -2020/21	36
Drejtoria e Autorizimit të Pagesave	37
Përmbledhje ekzekutive	37
Aktivitetet e realizuara për autorizimin e pagesave	37
Autorizimi i projekteve nga vitet paraprake të mbetura obligime të kontraktuara	38
Autorizimi i projekteve nga programi 2020/2021	39
Aktivitetet tjera të zhvilluara në drjtorinë e autorizimit.....	46
Vështirësit gjatë implementimit të programit 2020/2021	47
Nevojat e DAP-it për vitin 2022	48
DREJTORIA E PAGESAVE DIREKTE	49
Pagesat Direkte për mbjellje vjeshtore – grurë	49
Pagesat Direkte - farë gruri	52
Pagesat Direkte – Misër	52
Pagesat Direkte – Elb.....	53

Pagesat Direkte – Thekër	55
Pagesat Direkte – Tërsherë	56
Pagesat Direkte për bimë vajore – Luledielli.....	57
Pagesat Direkte – Perime	57
Pagesat Direkte - Pemishte ekzistuese	59
Pagesat Direkte – Mjedër për kg.....	60
Pagesat Direkte – Vreshtari	61
Pagesat Direkte - Bujqësi Organike	62
Pagesat Direkte - Bimë Mjekuese Aromatike – BMA.....	63
Pagesat Direkte - Material fidanor	64
Pagesat Direkte për blegtori – lopë qumështore dhe buallica.....	64
Pagesat Direkte për kafshë të imta - dele dhe dhi	66
Pagesat Direkte për kafshë të imta – dhi.....	67
Pagesat Direkte – Bletë	68
Pagesat Direkte – Thëllëza.....	70
Pagesat Direkte – Pula vojse.....	70
Pagesat Direkte – Dosa për riprodhim	71
Pagesat Direkte - Verë e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht	72
Pagesat Direkte - Qumësht sipas cilësisë - gjashtëmujori i parë 2021	73
Pagesat Direkte - viça për majmëri për gjashtëmujorin e parë 2021	75
Pagesat Direkte - viça për majmëri për gjashtëmujorin e dytë 2021	76
Pagesat Direkte - therret e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i parë 2021	78
Pagesat Direkte - therret e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i dytë 2021.....	78
Pagesat Direkte – Akuakulturë gjashtëmujori i parë 2021	78
Pagesat Direkte – Akuakulturë gjashtëmujori i dytë 2021	79
Pagesat Direkte – Primi i sigurimit bujqësor	79
Përmbledhje e raportit për Pagesa Direkte, 2021.....	80
Drejtoria e Kontrollit.....	85
Hyrje	85
AKTIVITETET E ZHVILLUARA NGA DREJTORIA E KONTROLLIT GJATË VITIT	
2021.....	86
RESURSET NË DISPOZICION PËR DREJTORINË E KONTROLLIT	87
KONTROLLI I LËNDËVE PËR PAGESA DIREKTE.....	89
AKTIVITETET E ZHVILLUARA VJETORE	92
KONTROLLI I LËNDËVE PËR PAGESA DIREKTE.....	92

Ex-Post Kontrolli	99
Vështirësitë në Kontrollin e Pagesave Direkte	99
Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit.....	101
Trajnimet dhe takimet.....	102
Vazhdimi i Kontrollit në terren i Projekteve të vitit 2019 të bartura në vitin 2020-2021.....	102
Vështirësitë gjatë kontrollit në terren për Projektet e Zhvillimit Rural	109
Të arriturat	110
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	110
PËRFUNDIM	112
DREJTORIA PËR KOORDINIM ME ZYRET REGJIONALE.....	112
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (IT)	113
Hyrje	113
Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)	117
Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS).....	120
Regjistri i Granteve.....	127
Miratimi i granteve	128
Autorizimi i Pagesave.....	129
Moduli i kontrollit në terren.....	130
Moduli për kërkesën për pagesë	131
Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte.....	132
Ueb faqja.....	135
Auditimi i Brendshëm - AZHB.....	136
DETYRAT E AUDITIMIT	136
Auditimet sipas Planit Vjetor të Auditimit	136
Auditimet me kërkesë nga menaxhmenti.....	137
DETYRAT E KONSULENCËS.....	138
TË TJERA.....	138
Tabela 1 Numri i zyrtarëve në AZHB	8
Tabela 2 Struktura profesionale e të punësuarve në AZHB.....	9
Tabela 3 Struktura Gjinore e të punësuarve në AZHB	9
Tabela 4 Shtojcat/Anekset të dhënat tabelore-statistikore	11
Tabela 5 Tabela e shkresave të protokoluara sipas muajve	12
Tabela 6 Aktivitetet e sektorit ligjor.....	14

Tabela 7 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 101 thirrja e parë.....	17
Tabela 8 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 103 thirrja e parë.....	18
Tabela 9 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 302 thirrja e parë.....	19
Tabela 10 Ndarja e planifikuar buxhetore thirrja e parë.....	20
Tabela 11 Ndarja e planifikuar buxhetore per te gjitha masat thirrja e parë.....	20
Tabela 12 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 101 thirrja e dytë.....	21
Tabela 13 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 302 thirrja e dytë.....	22
Tabela 14 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 303 thirrja e dytë.....	22
Tabela 15 Ndarja e planifikuar buxhetore për të gjitha masat thirrja e dytë.....	22
Tabela 16 Masa 101- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë.....	23
Tabela 17 Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë.....	23
Tabela 18 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë.....	24
Tabela 19 Ujitja e tokave bujqësore.....	25
Tabela 20 Gjithsejt numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për te gjitha masat thirrja e parë.....	25
Tabela 21 Masa 101- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë.....	26
Tabela 22 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë.....	27
Tabela 23 Masa 303 -Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë.....	27
Tabela 24 Të gjitha masat – Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë.....	27
Tabela 25 Totali i projekteve të miratuara dhe vlera e miratuar thirrja e parë PZHR 2020/21.....	29
Tabela 26 Numri i aplikacioneve në PZHR gjatë viteve (sipas sektorëve përkatës) 2016-2020/21.....	32
Tabela 27 Vlera e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2016-2020/21.....	33
Tabela 28 Numri i projekteve të miratuar gjate viteve 2016-2020/21.....	35
Tabela 29 Autorizimi i obligimeve.....	38
Tabela 30 Numri i projekteve të miratuara për programin 2020/2021.....	39
Tabela 31 Numri dhe vlerat e autorizuar sipas Masave, viti 2020/2021.....	40
Tabela 32 Obligimet e kontraktuara nga programi i vitit 2018 dhe programi i vitit 2020/2021 të bartura në vitin 2022.....	45
Tabela 33 Të dhëna për Pagesat Direkte për sipërfaqe të grurit për vitin 2021, sipas komunave.....	50
Tabela 34 Të dhëna për Pagesat Direkte për kilogram të grurit për vitin 2021, sipas komunave.....	51
Tabela 35 Pëfituesit dhe sipërfaqja e subvencionuar për prodhuesit e farës së grurit sipas komunave, 2021.....	52
Tabela 36 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave - misër 2021.....	53
Tabela 37 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pagesa Direkte për elb, 2021.....	55
Tabela 38 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pagesa Direkte për thekër, 2021.....	55
Tabela 39 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pagesa Direkte për tërshërë, 2021.....	57
Tabela 40 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pagesa Direkte për luledielli, 2021.....	57
Tabela 41 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Perime, 2021.....	58
Tabela 42 Të dhëna për pagesat direkte për pemishtet ekzistuese sipas komunave për vitin 2021.....	60
Tabela 43 Të dhëna për Pagesat Direkte për mjedër të dorëzuar sipas komunave, 2021.....	61
Tabela 44 Të dhëna për Pagesat Direkte për vreshtat ekzistuese sipas komunave, 2021.....	62
Tabela 45 Të dhëna për Pagesat Direkte për bujqësi organike, sipas komunave, 2021.....	63
Tabela 46 Të dhëna për Pagesat Direkte për BMA, sipas komunave, 2021.....	64
Tabela 47 Të dhëna për Pagesat Direkte për material fidanor, sipas komunave, 2021.....	64
Tabela 48 Të dhëna për Pagesat Direkte për lopë qumështore, sipas komunave, 2021.....	65
Tabela 49 Të dhëna për Pagesat Direkte për dele qumështore, sipas komunave, 2021.....	67
Tabela 50 Të dhëna për Pagesat Direkte për dhi sipas komunave, 2021.....	68
Tabela 51 Të dhëna për Pagesat Direkte për bletë, sipas komunave, 2021.....	70

Tabela 52 Të dhëna për Pagesat Direkte për thëllëza, sipas komunave, 2021	70
Tabela 53 Të dhëna për Pagesat Direkte për pula vojse, sipas komunave, 2021	71
Tabela 54 Të dhëna për Pagesat Direkte për dosa, sipas komunave, 2021	72
Tabela 55 Pagesat Direkte për verë të prodhuar dhe deklaruar, sipas komunave, 2021	72
Tabela 56 Pagesat Direkte për qumësht sipas cilësisë për gjashtëmujorin e parë, 2021	74
Tabela 57 Pagesat Direkte për qumësht sipas cilësisë për gjashtëmujorin e dytë, 2021	75
Tabela 58 Pagesa Direkte për viça për majmëri për gjashtëmujorin e parë, sipas komunave 2021	76
Tabela 59 Pagesa Direkte për viça për majmëri për gjashtëmujorin e dytë, sipas komunave 2021	77
Tabela 60 Pagesa Direkte për therjet e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i parë sipas komunave, 2021	78
Tabela 61 Pagesa Direkte për therjet e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i dytë sipas komunave, 2021	78
Tabela 62 Pagesat Direkte për akuakulturë, gjashtëmujori i parë, sipas komunave, 2021	79
Tabela 63 Pagesat Direkte për akuakulturë, gjashtëmujori i dytë, sipas komunave, 2021	79
Tabela 64 Pagesat Direkte për Primin e sigurimeve bujqësore, sipas komunave, 2021	79
Tabela 65 Pagesat Direkte sipas sektorëve, 2021	84
Tabela 66 Qarkullimi i lëndëve të Pagesave Direkte gjat vitit 2021	95
Tabela 67 Numri i Aplikantëve për Pagesa Direkte, Numri i Aplikantëve të Kontrolluar dhe shprehja në % e kontrollit	96
Tabela 68 Normat e parapara 100% për kontrollë sipas Mostrës dhe realizimi i kontrollit në totalin e Aplikantëve të paraparë për kontrollë	96
Tabela 69 Ne meny tabelare po i paraqesim numrin e kontrollave neper vite prej vitit; 2013 – 2021	97
Tabela 70 Numri i gjithmbarshëm i Kontrolleve të Realizuara në teren për Projektet e Zhvillimit Rural gjat vitit 2021 , sipas Masave të Miratuara	103
Tabela 71 Totali i Kontrolleve të rregullta për PZHR – 2019 të realizuara në vitin 2021 dhe 2020- 2021	104
Tabela 72 Kontrolla e dytë (para Pagesës për PZHR- 2019 të kryera në vitin 2021)	105
Tabela 73 Kontrollat e para (para Pagesës për PZHR- 2020-2021)	105
Tabela 74 Kontrollat e dytë (para Pagesës për PZHR- 2020/2021)	106
Tabela 75 Numri i Përgjithshëm i Kontrolleve në teren i realizuar gjat vitit - 2021	110
Tabela 76 Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet sipas Planit Vjetor	137

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme




Figura 1 Organogrami i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë-MBPZHR

Sektori i Personelit

Muaji	Akt-emërim	Me procedurë të prokurimit	Me bankë botërore	Me marrëveshje mes AZHB-APRK-MPMS
Janar	67	0	0	0
Qershor	70	0	20	0
Dhjetor	69	6	16	17

Tabela 1 Numri i zyrtarëve në AZHB

Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale në AZHB është e dominuar nga punëtorët me përgatitje të lartë profesionale të profilit Agronom dhe Ekonomist.

Nr. rend	Pergatitja Profesionale	Numri i të punësuarve
1	Bujqësi & Agronom	31
2	Ekonomist	22
3	Jurist	7
4	Shkollë Profesionale	1
5	Shkenca Kompjuterike/TI	2
6	Shkencat matematikore	1
7	Gjeografi	1
8	Gazetari	1
9	Shkolla e mesme	2
10	Shkolla fillore	1
	Gjithsejt	69

Tabela 2 Struktura profesionale e të punësuarve në AZHB

Nr rend	Gjinia e të Punesuarve	Numri
1	Femra	20
2	Meshkuj	49
	Total	69

Tabela 3 Struktura Gjinore e të punësuarve në AZHB

Sektori i personelit gjatë vitit 2021 ka pasur një rrugëtim të mirë në realizimin e aktiviteteve të parapara me planin e punës. Mungesa e stafit, mos trajnimi i tyre ka bërë që të kemi ngecje në përdorimin sidomos, të sistemit informativ të menagjimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). Sistem ky, pak i njohur nga zyrtarët e AZHB-së. Sido qoftë edhe pse në mungesë të stafit në burime njerëzore, jemi munduar që ti eliminojmë problemet e shkaktuara në këtë zyre.

Që në fillim të vitit kemi bërë draft planin e personelit dhe planin e personelit dhe e kemi dërguar në DASHC për aprovim përmes sistemit (SIMBNJ).

- Përgatitja dhe përcjellja e kërkesave të ndryshimeve të pagave Janar- Dhjetor 2021 në thesarin e Kosovës;
- Përgatitja dhe përcjellja në DMZP-MPB e raportit vjetor për menagjimin e burimeve njerëzore;
- Përgatitja në sistemin informativ për menagjimin e burimeve njerëzore lidhur me planet e punës dhe vlerësimet e performancës;
- Takim me zëvendës drejtorin ekzekutiv lidhur me njoftimin nga divizioni i personelit në MBPZHR lidhur me transferimin e listës së pagave të tri pastrueseve të zyreve regjionale pa diskutimin e kësaj çështje me AZHB-në;
- Menaxhimi i sistemit menagjues të vijimit në punë;
- Përcjellja e dokumenteve të kërkuara nga auditorët gjeneral të ZAP-it;
- Procedimi i kërkesave për ID kartela në sistemin SMAED;

- Njoftimi për deklarimin e rregullt të pasurisë dhe dhuratave për zyrtarët e lartë publik, bazuar në ligjin e deklarimit të pasurisë nr. 04/L-050 dhe nr. 04/L-228;
- Përcjellja e formularit me të dhënat për strukturën etnike, gjinore të posteve udhëheqëse në AZHB, sipas kërkesës;
- Përcjellja e dokumenteve të kërkuara nga Policia e Kosovës;
- Përgatitja dhe përcjellja e Raportit për mbrojtjen, respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut;
- Marrëveshja e transferimit të zyrtarit z. Gazmend Sylja nga AZHB në AUV;
- Kërkesa dhe përfundimi i rekrutimit për pozitën “ Menaxher Personelit “;
- Përgjigje në kërkesën nga DASHC-MPB, lidhur me deklarimin e pozitave të lira në AZHB;
- Përcjellja e të dhënave për qarkoren buxhetore për personel, kërkesë kjo nga MBPZHR-ja;
- Menaxhimi i pushimeve zyrtare përmes excell-it;
- Lëshimi i vërtetimeve sipas kërkesave;
- Kalimi i aplikimit të pushimeve zyrtare përmes sistemit të SIMBNj-së;
- Përgatitja dhe evidentimi i vijshmërisë mujore të zyreve regjionale të AZHB-së;
- Vendimi për lirim nga detyra e shërbimit civil për z. Shkumbin Zhegrova-dorëheqje;
- Përgatitja e shkresës në MPB, për aprovim të transferimit të përkohshëm në interes të institucionit nga MAPL në AZHB;
- Menaxhimi i sistemit të ID kartelave – SMAED;
- Menaxhimi i sistemit të konkurseve – HRMIS;
- Përcjellja e të dhënave rreth situatës së vaksinimit të zyrtarëve në AZHB;
- Menaxhimi i listës me staf esecial në punë;
- Përcjellja e të dhënave rreth procedurave të kontratave me shërbime të veçanta, sipas kërkesës nga DASHC-MPB-ja;
- Takim me Komisionin sipas vendimit me nr. prot. 4203 i datës 18.06.2021 për shqyrtimin e lëndëve pas ankesave për pagesë;
- Hapja e konkursit për rekrutim për pozitën “Auditor i brendshëm“ lëvizje paralele;
- Pranimi dhe shqyrtimi i 6 kërkesave për Komision Disiplinor;
- Rekrutimi i 10 pozitave me procedurë të prokurimit;
- Pranimi i 4 vërejtjeve për zyrtarët;
- Lëshimi i 5 ndalesave administrative;
- Lëshimi i 39 vërtetimeve për zyrtarët;
- Pranimi i 17 aplikantëve-punëkërkesit, sipas marrëveshjes mes AZHB-APRK-MPMS-së nëpër zyret regjionale;
 - Zyra Regjionale në Prishtinë 6 punëkërkes;
 - Zyra Regjionale në Mitrovicë 8 punëkërkes;
 - Zyra Regjionale në Prizren 2 punëkërkes;
 - Zyra Regjionale në Gjilan 1 punëkërkes;
- Pranimi i një eksperti të rekrutuar në bashkëpunim me Bankën Botërore;
- Pranimi i 3 vendimeve të pushimeve të lehonis;

- Përgatitja e raporteve dhe kompenzimet e orëve shtesë jasht orarit të punës për zyrtarët e rekrutuar nga Banka Botërore dhe zyrtarët me procedurë të prokurimit;

Vërtetim	39
Ndalesa administrative	5
Paga jubilarë	2
Pensionet	1
Kërkesa për komision dicitlinor	6
Pezullimet	11
Vërejtje	4

Tabela 4 Shtojcat/Anekset të dhënat tabelore-statistikore

Sektori i Logjistikës

Raportin final për regjistrimin e inventarizimit vjetor të pasurisë jofinanciare, sipas vendimit të nxjerrur nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së, të datës 20.10.2020 me numër protokoli 4170 të MBPZHR-së në pajtim me nenin 4, paragrafi 6, neni 5, 18, dhe 19 të Rregullores MF-NR 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore të dt 18/11/2013.

Kemi përgatitur raportin final sipas vendimit të nxjerrur nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR, të datës 11.09.2020 me numër protokoli 3637.

Kemi përgatitur raportin për shpenzime të karburanteve për çdo muaj, ku litrat e shpenzuara kanë rezultuar me 6.261, ndërssa km e shpenzuara 68414 gjatë perudhes Janar-Maj 2021.

Kemi pranuar edhe fatura të qirasë nga zyret regjionale dhe kemi bërë procedimin e tyre për pagesë:

- Nga Regjioni i Prizrenit kemi pranuar 10 fatura;
- Nga Regjioni i Gjakovës kemi pranuar 10 fatura;
- Nga Regjioni i Gjilanit kemi pranuar 10 fatura;
- Nga Regjioni i Mitrovicës kemi pranuar 10 fatura të cilat i kemi proceduar për pagesë.
- Nga Regjioni i Mitrovicës Veriore kemi pranuar 10 fatura të cilat i kemi proceduar për pagesë;
- Nga objekti i AZHB-së kemi proceduar 10 fatura;

Kemi pranuar edhe fatura për shpenzimin e Energjisë Elektrike dhe kemi bërë procedimin e tyre për pagesë;

- Nga Regjioni i Gjilanit kemi pranuar 10 fatura;
- Nga Regjioni i Prizrenit kemi pranuar 10 fatura;
- Nga Regjionii Mitrovicë kemi pranuar 10 fatura te cilat i kemi proceduar për pagesë.

Arkiva

Arkiva e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë apo Sektori për Menaxhimin e Dokumentacionit, është përgjegjëse për qarkullimin e dokumentacionit mbrënda AZHB-së, Zyreve Regjionale dhe jashtë AZHB-së:

- Arkiva menaxhon punën e përgjithshme të AZHB-së dhe ndihmon Drejtoritë;
- Është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë së lidhur me arkivimin e lëndëve;
- Si detyrë e Arkivës së AZHB-së është pranimi i të gjitha shkresave të jashtme dhe të brendshme si: Kërkesa, ankesa, njoftime, vendime, raporte, aktvendime, aktgjykime, si dhe shumë shkresa tjera të cilat protokolohen, skanohen dhe dërgohen në mënyrë elektronike zyrtarëve dhe fermerëve përkatës;
- Po ashtu Arkiva ka dhe disa detyra të tjera për shpërndarjen e shkresave të ndryshme në mënyrë fizike nëpër institucione të ndryshme si: Posta, ministri të ndryshme, përmbarues, gjykatë etj.
- Arkiva siguron mirëmbajtjen e regjistrave gjithëpërfshirës për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe ofron informata statistikore dhe të tjera për udhëheqësin e drejtorisë dhe organet e jashtme sipas kërkesës;
- Bashkangjitur gjeni Raportin Vjetor të Arkivës të vitit 2021 ku numri i shkresave të protokoluara gjithsej është **7521**.

<i>Muaji</i>	Numri Gjithësej i Protokolit
<i>Janar</i>	430
<i>Shkurt</i>	576
<i>Mars</i>	423
<i>Prill</i>	765
<i>Maj</i>	773
<i>Qershor</i>	1629
<i>Korrik</i>	624
<i>Gusht</i>	345
<i>Shtator</i>	441
<i>Tetor</i>	332
<i>Nëntor</i>	432
<i>Dhjetor</i>	751
<u>TOTAL</u>	7521

Tabela 5 Tabela e shkresave të protokoluara sipas muajve

Arkiva si një ndër zyret më të rëndësishme të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë gjatë vitit 2021 ka arritur numrin e protokollit deri në **7521**, ku gjatë muajit maj dhe qershor për shkak të fluksit të madh të punës me palë dhe kërkesave interne brenda Agjencionit ka arritur një numër më të madh në krahasim me muajt e tjerë të vitit.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi hasur me shumë (modifikime) të dokumenteve nga Drejtoritë në AZHB, si DA-Drejtoria për Autorizimin e Pagesave dhe PZHR-Drejtoria për Miratimin e Projekteve, etj.

Po ashtu si Arkivë kemi hasur me disa vështirësi gjatë arkivimit të lëndëve dhe bartjen e tyre për shkak se Arkiva ka mbetur në objektin e mëparshëm dhe nuk mund të marrim përgjegjësi për lëndët në fjalë. Që nga transferimi në objektin e ri nuk kemi vend për arkivë në objekt dhe lëndët të cilat gjenden në zyre nuk mund të themi se janë të sigurta për shkak se kemi punë me palë.

Sektori Ligjor

Nr.	Lënda	Përshkrimi	Shënimet
1.	Ankesë	PZHR: Deri me tani 463 të pranuar dhe të trajtuara nga Komisioni dhe 27 janë në procedure. PD: 265 të pranuar dhe të shqyrtuara nga Komisioni.	Numri i përgjithshëm 728 ankesa
2.	Padi	Sipas Kërkesës së Drejtorisë së Autorizimit kemi hartuar dhe proceduar Padi për kthim të mjeteve për GLV - Procesi Obiliq, çështje civile në vlerë 15,808.00euro. Laberion sh.p.k. Podujevë çështje civile 98,455.25euro. Remzie Qelaj, Glllogoc çështje civile 5,909.40euro. Tekno Konstrukt sh.p.k. Skendëraj, çështje civile 68,650.00 euro.	4
	Aktvendime për përgjigje në padi	Kemi pranuar nga Gjykatë Themelore 36 aktvendime ku kemi qenë të obliguar t'i përgjigjemi në padin e paditëseve.	Aktvendime 36
3.	Përgjigje në padi	Sipas Aktvendime nga Gjykatat Themelore kemi hartuar dhe proceduar deri me tani 36 përgjigje në padi prej tyre 32 çështje administrative dhe 4 çështje civile.	Përgjegji në padi 36
4.	Përfaqësimi në gjykatë	Duke filluar nga janari e deri me tani kam përfaqësuar në 45 seanca	45
7.	Nga Gjykata e Apelit	<ul style="list-style-type: none"> • Aktvendime 3 • Aktgjykime 5 	Gjithsejt 8
8.	Aktgjykime/ Gjykata Themelore	18 aktgjykime për çështje administrative:	Aktgjykime 33

		6 janë refuzuar padia e paditësit ndërsa 12 është anuluar vendimi i komisionit i MBPZHR lëndët janë kthyer në dhe rivendosje rishqyrtim. 13 Aktgjykime për çështje civile: 9 miratime të padisë dhe kërkesëpadisë së AZHB-së; 2 refuzim i padisë dhe Kërkesëpadisë së AZHB-së; 2 miratim të padisë së paditësit ndaj AZHB-së 1 Aktgjykim PKR.nr.94/2019 të datës 1 Aktgjykim C.nr.117/2021 , gjykata është shpallur jo kompetete në padin e paditese.	
9.	Ankesë dhe përgjigje në ankesë	<ul style="list-style-type: none"> • 3 ankesa ndaj aktgjykimeve në çështje civile. • 2 përgjigje në ankesë 	Gjithsej 5
10.	Parashtrësia në çështje administrative	Tek kontestet administrative kemi paraqitur parashtrësë Konform nenit 38 par.5 të LKA-së.	Gjithsej 22
11.	Procedura përmabrimore	<ul style="list-style-type: none"> • Janë bërë 11 Propozime përmabrimore pas aktgjykimeve të formës së prerë • tri prapësim për përmabarim. 	11 propozime për përmabarim 3 prapësime për Propozimin e përmabaruesit
12.	Opinion dhe këshilla ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Sipas nevojës dhe kërkesave janë kthyer të gjitha përgjigjet. 	
13.	Vendime	<ul style="list-style-type: none"> • Janë hartuar të gjitha draft vendimet sipas kërkesë së Kryeshefit Ekzekutiv 	
	Revizion dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë	<ul style="list-style-type: none"> • Revision në gjykatën supreme 3 • Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë 2. 	Revizion dhe Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë 5
	Aktgjykim nga Gjkata Supreme	<ul style="list-style-type: none"> • 2 aktgjykime janë refuzuar revizionet e paditëseve kundrejt AZHB-së • 1 Aktvendim është hudhë poshtë revizioni i AZHB-së kundrejt të paditurit 	Gjithsej 3

Tabela 6 Aktivitetet e sektorit ligjor

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, bazuar edhe në Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 04-L 090, U/A, si dhe Rregulloren e Brendshme, është themeluar Drejtoria për Buxhet dhe Financa për funksionalizimin e AZHB-së. Kjo Drejtori është krijuar në fillim të vitit 2018 me rekrutimin e Drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe njëkohësisht në kuadër të kësaj Drejtorie janë edhe tre zyrtarë tjerë të domosdoshëm për funksionimin e kësaj Drejtorie: Zyrtari Çertifikues dhe aprovues i pagesave, zyrtari Shpenzues si dhe zyrtari për Zotimin e mjeteve. Gjatë vitit 2018-2021 stafi i kësaj Drejtorie është çertifikuar nga Ministria e Financave për mundësinë e qasjes në programin Free-Balance si dhe në Programet e BDMS-së si mundësi për realizim të pagesave dhe detyrave të ndryshme në kuadër të AZHB-së.

Në periudhën kohore janar-dhjetor 2021, Drejtoria për Buxhet dhe Financa është marrë me punë dhe detyra në kuadër të AZHB-së, bazuar edhe në Ligjin mbi Financat Publike si dhe standartet për raportim financiar. Gjatë kësaj kohe në koordinim me Zv. Kryeshefin e AZHB-së, kemi përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024, si dhe kemi bërë qarkoren buxhetore për vitin 2022. Ky Departament në kuadër të punëve dhe detyrave që ka, është marrë edhe me monitorimin dhe kontrollin e shpenzimeve të AZHB-së, për Grante dhe Subvencione si dhe shpenzimeve administrative.

Vlenë të theksohet se përkundër çertifikimit të stafit nuk kemi qasje në programin Free-Balance, BDMS dhe PIP (programe për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit) i cili na mundëson që të kryejmë pagesat në mënyrë të pavarur dhe direkte andaj jemi në pritje dhe planifikojmë se me fillim të vitit 2022 këto pagesa do realizohen nga Drejtoria e Financave në kuadër të AZHB-së pasi që është njëri ndër kriteret e KE-së për akreditim lidhur me menaxhimin e fondeve IPARD. Deri më tani këto pagesa bëhen në kuadër të MBPZHR-së.

Vërejte: Në raport nuk janë paraqit të dhënat e shpenzimeve pasi që nuk kemi qasje në programin e Free Balance.

Drejtoria i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural

Gjatë vitit 2020/21 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - Gjegjësisht nga Drejtorati i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është bërë zbatimi i Programit të Zhvillimit Rural – duke përfshirë masat ,nën-masat dhe sektorët e Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2020/21

Duhet theksuar se në vitin 2020 ka qenë i përgatitur Programi për Zhvillimi Rural si tërësi për vitin 2020-21 ndërsa plani operacional për thirrjen për aplikim ka qenë i dizajnuar në dy periudha kështu që për periudhen e parë AZHB-ja ka publikuar thirrjen për aplikim për masat, nën masat dhe sektorët përkatës si në vijim:

MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore:

Sektori 101. - Pemë drufrutore;

Sektori 101.1.1 - Pemë arrore;

Sektori 101.2 – Serra.

MASA 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore:

Sektori 103.1- Përpunimi i qumështit;

Sektori 103.2- Përpunimi i mishit;

Sektori 103.3- Përpunimi i pemëve dhe primeve;

Sektori 103.4- Prodhimi i verës.

MASA 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve:

Nën-masa 302.1 – Bletaria, prodhimi, promovimi i mjaltit;

Nën-masa 302.3 – Përpunimi i prodhimeve në fermë;

Nën-masa 302.4 – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale;

Nën-masa 302.7 – Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish.

MASA: Ujitja e tokave bujqësore.

Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore

Objektivat e përgjithshme

Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë Kosovare dhe zëvendësimi i importit;

Krijimi i vendeve të reja të punës në bujqësi dhe zonat rurale;

Përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së;

Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;


Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Buxheti i paraparë sipas programit për thirrjen e parë

Ndarja e planifikuar buxhetore sipas Programit për Zhvillim Rural ndërmjet sektorëve për vitin 2020/21 për masën 101 me sektorët përkatës të publikuar për thirrjen e parë ishte planifikuar sipas tabelës në vijim.

Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Buxheti €	%
101.1. Pemë drufrutore	3,200,000	46
101.1.1 Pemë arrore (arra, lajthia)	800,000	11
101.2.1- Perime dhe serra	3,000,000	43
TOTALI	7,000,000	100

Tabela 7 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 101 thirrja e parë



Grafikoni 1 Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore - Sipas sektorëve

Nga të dhënat në tabelën nr 1 dhe grafikonin nr 1 përqindjen më të madhe të buxhetit për masën 101 për thirrjen e parë është parapar për tu shpenzuar tek sektori për pemë drufrutore 46%, perime dhe serra me nga 43 %, dhe sektori pemë arrore 11%.

Masa 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore”

- Sektorët përkatës.

Objektivat e përgjithshme

Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor dhe zëvendësimi i importit, përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja;

Rritja e sigurisë dhe cilësisë së produkteve;

Përkrahja e ndërmarrjeve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit të ushqimit dhe menaxhimin e mbeturinave;

Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;


Forcimi i lidhjeve me prodhimin primar;

Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatike përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Ndarja e planifikuar buxhetore sipas Programit për Zhvillim Rural ndërmjet sektorëve për vitin 2020/21 për masën 101 me sektorët përkatës të publikuar për thirrjen e parë ishte planifikuar sipas tabelës në vijim:

Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	Buxheti €	%
103.1-Perpunimi i qumështit	1,700,000	25
103.2- Përpunimi i mishit	2,000,000	29
103.3- Përpunimi i pemëve dhe perimeve	2,100,000	31
103.4- Prodhimi i verës	1,000,000	15
TOTALI	6,800,000	100

Tabela 8 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 103 thirrja e parë



Grafikoni 2 Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore - Sektorët përkatës.

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme dhe Grafikonin nr. 2 për masën 103 „Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore” përqindja më e madhe e buxhetit për përkrahje të kjo mase është të sektori 103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve 31 % pastaj sektori 103.2 perpunimi i mishit 29% , sektori 103.1 Përpunimi i qumështit 25% dhe sektori 103.4 Prodhimi i verës 15%.

Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve 2020 -21

Objektivat e përgjithshme

Krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nëpërmjet diversifikimit;


Krijimi i kushteve të përshtatshme për parandalimin e shpërnguljes së popullatës së zonave rurale dhe zonave malore;

Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale;

Në thirrjen e parë për aplikim është bërë publikimi i këtyre nën-masave dhe ndarja e planifikuar e buxhetit si në tabelën e mëposhtme:

Masa 302: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	Buxheti €	%
302.1. Prodhimi i mjaltit	700,000	33
302.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara në ekonomi familjare	600,000	29
302.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	300,000	14
302.7. Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	500,000	24
TOTALI	2,100,000	100

Tabela 9 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 302 thirrja e parë



Grafikoni 3 Masa 302 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme dhe Grafikonin nr. 3 për Masa 302 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale përqindja më e madhe e buxhetit për përkrahje të kësaj masë është tek 302.1. Prodhimi i mjaltit 33% pastaj 302.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara në ekonomi familjare me 29 % pastaj 302.7. Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish me 24 % dhe 302.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale me 14%.

Masa për ujitjen e tokave bujqësore

Objektivat e përgjithshme

Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore;

Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;

Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.


Sektorët	Vlera në €	%
Ujitje e Tokave Bujqësore	800.000	100
TOTALI	800.000	100

Tabela 10 Ndarja e planifikuar buxhetore thirrja e parë


Gjithsejt buxheti i paraparë për Programin e Zhvillimit Rural 2020-21 me thirrjen e parë që u implementua gjatë vitit 2020 për të gjitha masat e publikuara ishte :

Masat	Vlera në euro	% e buxhetit
Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	7,000,000	42
Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	6,800,000	41
Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	2,100,000	13
Ujitja Ujitja e Tokave Bujqësore	800,000	5
TOTALI	16,700,000	100

Tabela 11 Ndarja e planifikuar buxhetore për të gjitha masat thirrja e parë



Grafikoni 4 Buxheti i paraparë sipas masave në €



Grafikoni 5 Buxheti i paraparë për të gjitha masat në %

Thirrja e dytë e PZHR 2020-21 duke përfshirë masat dhe sektorët përkatës është publikuar me datën 30.01.2021 dhe ka zgjat deri me datën 1.03.2021

Buxheti i paraparë sipas programit për thirrjen e dytë

Ndarja e planifikuar buxhetore sipas Programit për Zhvillim Rural ndërmjet sektorëve për vitin 2020/21 për masen 101 me sektorët përkatës të publikuar për thirrjen e dytë ishte planifikuar sipas tabelës në vijim.

Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Buxheti €	%
101.2 Pemë manore	1,500,000	14.12
101.2.2 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,200,000	11.30
101.3.1 Prodhimi i mishit/ rritja e viçave	2,500,000	23.50
101.3.2 Prodhimi i mishit /rritja e derrave	400,000	3.76
101.4.1 Prodhimi i qumështit/lopë qumështore	2,500,000	23.50
101.4.2 Prodhimi i qumështit /dele dhe dhi	420,000	3.95
101.4.3 Pikat grumbulluese të qumështit	500,000	4.70
101.5 Prodhimi i rrushit	900,000	8.47
101.6 Prodhimi i vezëve	700,000	6.70
TOTALI	10,620,000	100%

Tabela 12 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 101 thirrja e dytë

Ndarja e planifikuar buxhetore sipas programit për zhvillim rural ndërmjet sektorëve për vitin 2020/21 për **Masën 302 Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve me nënmasat përkatës** e të publikuar për thirrjen e dytë ishte planifikuar sipas tabelës në vijim:

Masa 302: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	Buxheti €	%
302.2 Grumbullimi përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit	700,000	40
302.5 Zhvillimi i turizmit rural	700,000	40
302.6 Akuakultura /kultivimi i peshkut	350,000	20
TOTALI	1,750, 000	100%

Tabela 13 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 302 thirrja e dytë

Ndarja e planifikuar buxhetore sipas programit për zhvillim rural ndërmjet sektorëve për vitin 2020/21 për Masën 303,, Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e perzgjedhura ‘ thirrja e dytë.

Masa 303: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e perzgjedhura	Buxheti €	%
Masën 303 Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER per GLV-të e perzgjedhura	300,000	100
TOTALI	300,000	100%

Tabela 14 Ndarja e planifikuar buxhetore Masa 303 thirrja e dytë

Masat/thirrja e dytë	Vlera në euro	% e buxhetit
Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	10,620,000	83.82
Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	1,750, 000	13.81
Masa 303 „ Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e perzgjedhura ‘	300,000	2.37
TOTALI	12,670,000	100%

Tabela 15 Ndarja e planifikuar buxhetore për të gjitha masat thirrja e dytë

Procedurat e zbatimit të Projekteve të Zhvillimit Rural

Aplikimi

Aplikimi për programin e zhvillimit rural 2020-21 ka qenë online.

Aplikimi është bërë përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “aplikimi online PZHR” që dërgon në modulën e aplikimit online në web-modul ku është regjistruar projekti si dhe ngarkimi (upload) i dokumenteve të nevojshme për aplikim në PDF.

Faza e aplikimit – Është aktivitet i cili është kryer përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “aplikimi online PZHR” që dërgon në modulën e aplikimit online në web-modul ku është regjistruar projekti si dhe ngarkimi (upload) i dokumenteve të nevojshme për aplikim në PDF për të gjitha masat dhe nënmasat e PZHR-së 2020- 21. Afati i aplikimit ka zgjatë nga

data 20.07.2020 deri me datën 20.08.2020. dhe pastaj në bazë të kërkesës për shtyrje të afatit nga fermerët kemi patur shtyrje të afatit deri me datën 28.08.2020 dhe gjatë kësaj periudhe kemi pasur këtë numër të aplikacioneve sipas masave dhe sektorëve përkatëse si në vijim:

Masa 101,, **Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore** ‘‘ duke përfshirë sektorët :


Sektori 101 - Pemë drufrutore;

Sektori 101.1 -Peme arrore;

Sektori 101.2 –Serra kemi pasur këtë numër dhe vlerë të aplikimeve:

Masa 101 Nën-sektorët	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e aplikuar €
101.1. Pemë drufrutore	275	19,306,242.84
101.1.1 Pemë arrore (arra, lajthia)	183	10,584,975.59
101.2.1- Sektorin e perimeve dhe serrave	364	16,982,261.11
TOTALI	822	46,873,479.54

Tabela 16 Masa 101- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë




Grafikoni 6 Masa 101 -Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar

Masa 103,, **Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore**’’ duke përfshirë sektorin e përpunimit të qumështit, sektori i përpunimit të mishit ,sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve dhe sektori i prodhimit të verës, aplikimi prej datës 20.07-28.08.2020 gjatë kësaj periudhe numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € ka qenë sipas sektorëve të paraqitur në tabelën në vijim:

Masa 103 Nën-sektorët	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e Aplikuar në €
103.1 Përpunimi i qumështit	8	2,892,343.23
103.2 Përpunimi i mishit	14	5,053,440.10
103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	36	12,389,553.33
103.4 Prodhimi i verës	7	2,867,677.40
TOTALI	65	23,203,014.06

Tabela 17 Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë




Grafikoni 7 Masa 103 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar

Masa 302 „Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale” Afati i aplikimit prej datës 20.07.2020 deri më datën 28.08.2020 dhe numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € e paraqitur në tabelën në vijim:

Masa 302 Nën-masa	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e Aplikuar në €
302.1 Prodhimi ,promovimi i mjaltit	227	4,411,007.63
302.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare	55	1,092,960.41
302.3 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	80	2,367,811.93
302.6 Rritja e shpezeve për vezë dhe mishë	128	2,696,700.83
TOTALI	490	10,568,480.80

Tabela 18 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e parë



Grafikoni 8 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar


Masa	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e Aplikuar në €
Ujitja e tokave bujqësore	11	2,140,451.07
Gjithsej	11	2,140,451.07

Tabela 19 Ujitja e tokave bujqësore

Në fund të thirrjes për aplikim kemi pasur këtë numër të aplikacioneve dhe këtë vlerë të aplikuar për thirrjen e parë për PZHR 2020-21 për të gjitha masat dhe nën-masat ishte sipas tabelës në vijim:

Masat	Numri i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €
101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	822	46,873,479.54
103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	65	23,203,014.06
302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	490	10,568,480.80
Ujitja e Tokave Bujqësore	11	2,140,451.07
Totali	1388	82,785,425.47

Tabela 20 Gjithsej numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për të gjitha masat thirrja e parë



Grafikoni 9 Gjithsej numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar


Nga të dhënat në tabelën/grafikonin më lartë për vitin 2020 gjithsej kishte 1388 aplikues me vlerë prej **82,785,425.47** euro. Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore kishte më së shumti aplikues, gjithsej 822 aplikues në vlerë prej **46,873,479.54** €, ndërsa në vendin e dytë me më së shumti aplikues ishte masa 302 me gjithset 490 aplikacione në vlerë prej **10,568,480.80** €, masa 103 me gjithsej 65 aplikues me një vlerë të aplikimit prej **23,203,014.06** € dhe masa Ujitja e tokave bujqësore me 11 aplikues me një vlerë të aplikimit prej **2,140,451.07** €.

Aplikimi / Thirrja e dytë PZHR 2020/21

Faza e aplikimit – Është aktivitet i cili edhe për thirrjen e dytë për PZHR 2020/21 është kryer përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net, në të cilën gjendej linku “aplikimi online PZHR” që dërgon në modulën e aplikimit online në web-modul ku është regjistruar projekti si dhe ngarkimi (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF për të gjitha masat dhe nënmasat e PZHR-së 2020- 21. Afati i aplikimit ka zgjatë nga data 30.01.2021 deri me datën 01.03.2021. dhe numri i aplikacioneve sipas masave dhe nënmasave ka qenë si vijon:

Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore	Numri i aplikacioneve	Vlera e Aplikuar
101.2 Pemë manore	122	7,148,309.89
101.2.2 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	102	6,442,093.52
101.3.1 Prodhimi i mishit/ rritja e vëçave	155	10,507,505.42
101.3.2 Prodhimi i mishit /rritja e derrave	17	1,082,259.01
101.4.1 Prodhimi i qumështit/lopë qumeshtore	207	13,261,356.68
101.4.2 Prodhimi i qumështit /dele dhe dhi	41	2,787,957.76
101.4.3 Pikat grumbulluese të qumështit	5	325,692.60
101.5 Prodhimi i rrushit	71	3,719,238.70
101.6 Prodhimi i vezeve	35	3,119,579.52
TOTALI	755	48,393,993.10


Tabela 21 Masa 101- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë



Grafikoni 10 Masa 101 -Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë

Masa 302: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	Numri i aplikacioneve	Vlera e aplikuar
302.2 Grumbullimi/përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit	9	454,256.66
302.5 Zhvillimi i turizmit rural	80	3,978,536.48
302.6 Akuakultura /kultivimi i peshkut	6	300,000.00
TOTALI	95	4,732,793.14

Tabela 22 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë




Grafikoni 11 Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë

Masa 303: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura	Numri i Aplikacioneve	Vlera e aplikuar
Masën 303 Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura	11	251,378.30
TOTALI	11	251,378.30

Tabela 23 Masa 303 -Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë

Masat thirrja e dytë	Numri i aplikacioneve	Vlera e aplikuar
Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore	755	48,393,993.10
Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	95	4,732,793.14
Masa 303 „ Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal Qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura “	11	251,378.30
TOTALI	861	53,378,164.54

Tabela 24 Të gjitha masat – Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar thirrja e dytë



Grafikoni 12 Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për të gjitha masat

Shqyrtimi administrativë, vlerësimi, kontrolli në terren dhe Miratimi i Projekteve të Zhvillimit Rural

Pas përfundimit të procesit të aplikimit ka filluar shqyrtimi administrativë mbi kriteret e pranueshmërisë dhe në këtë fazë të gjitha ato projekte që nuk i kanë plotësuar këto kriteret janë refuzuar, ndërsa ato projekte të cilat i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë dhe kompletimit të dokumentacionit të kërkuar kanë vazhduar me kriteret e përzgjedhjes (vlerësimit) të Projekteve të Zhvillimit Rural .

Pas përfundimit të kriterëve të përzgjedhjes (vlerësimit) është bërë rangimi i projekteve në bazë të poenave të fituara dhe në përputhshmëri me buxhetin në dispozicion janë përzgjedhë përfituesit e mundshëm të cilët me një urdhër kontrolli (lista e përfituesve të mundshëm) janë përcjellë të Drejtorati i Kontrollës për kontrollin e parë për të verifikuar edhe kushtet në vendngjarje, dhe për të parë se a janë plotësuar kriteret për të qenë përfitues i mundshëm.

Miratimi -Pas përfundimit të kontrollës së parë në terren ka vazhduar procesi i miratimit apo refuzimit të projektit .

Duke u bazuar në raportin e kontrollit të përpiluar nga inspektorët e Drejtoratit të Kontrollit.

Nëse është bërë miratimi i projekteve, atëherë është përgatitur letra informuese ku janë specifikuar kriteret e investimit, fushat në të cilat duhet të bëhet investimi, shuma e pranuar e investimit, koha e kryerjes së investimeve dhe koha për të bërë kërkesën për pagesë pas përfundimit të investimeve.

Pas këtij procesi është nënshkruar kontrata në mes të përfituesit dhe AZHB-së për të filluar me kryerjen e investimeve të parapara.

Nëse në bazë të raportit të kontrollës në terren, aplikuesit që nuk i ka plotësuar kriteret për të filluar investimet atëherë aplikacioni është refuzuar dhe është përpiluar vendimi për refuzim me arsyet e refuzimit dhe i është dërguar fermerit.


Me këtë edhe ka përfunduar procesi i miratimit të PZHR-së dhe ka vazhduar procesi i kryerjes së investimeve të pranuar për investimet e pranuar.

Nga numri i aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes, duke u bazuar në buxhetin e paraparë për PZHR-në dhe rezultateve të përzgjedhjes për vitin përkatës 2020 janë miratuar/kontraktuar gjithsej 338 projekte me një vlerë prej **11,488,437 €**.


Në tabelën e mëposhtme është paraqitur nr. i aplikacioneve të miratuara /kontraktuara dhe vlera e miratuar/kontraktuar e projekteve për vitin 2020 sipas nën masave dhe sektorëve përkatës.

Masa 101	Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	Nr. i Apl. të Miratuara/kontrakt.	Vlera e Miratuar në €
101.1	Sektori i pemëve drufrutorë	72	2,991,028.93
101.1.1	Sektori Peme arrore	28	100'3719.10
101.2	Sektori serra	117	3,143,879.35
Subtotali I		217	7,138,627.38
Masa 103	Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e Miratuar ne €
103.1	Përpunimi i qumështit	2	385,553 .00
103.2	Përpunimi i mishit	4	735393.00
103.3	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	10	1,768,491.00
103.4	Prodhimi i verës	4	799,800.00
Subtotali II		20	3,689237
Ujitja	Ujitja e tokave bujqësore- Sub totali III	1	160,000
Masa 302	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	Nr. i Aplikacioneve	Vlera e Miratuar në €
302.1	Prodhimi i mjaltit	56	653108.95
302.3	Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare.	18	243712.30
302.4	Zhvillimi i aktiviteteve artizanale.	14	267,575.00
302.7	Rritja e shpezëve për vezë dhe mishë	37	475,539.25
Subtotali IV		125	1639935.07
Totali I+II+III+IV		363	12,627799.45


Tabela 25 Totali i projekteve të miratuara dhe vlera e miratuar thirrja e parë PZHR 2020/21




Grafikoni 13 Masa 101 – Numri i projekteve të miratuara dhe vlera e miratuar



Grafikoni 14 Masa 103 – Numri i projekteve të miratuara dhe vlera e miratuar



Grafikoni 15 Masa 302 – Numri i projekteve të miratuara dhe vlera e miratuar



Grafikoni 16 Permbledhja e Projekteve të miratuara sipas masave.


Shqyrtimi administrativë, vlerësimi, kontrolli në terren dhe Miratimi i Projekteve të Zhvillimit Rural2020/21 Nuk është proceduar për thirrjen e dytë është shfuqizuar.

Nr.	Nën-Masat /sektorët	2016	2017	2018	2019	2020/21 Thirrja e parë	2020/21 Thirrja e dytë
1	Spektori i perimeve serrave - përfshirë patatet	269	240	273	275	364	-
2	Spektori pemëve drufrutore (mollë, dardhe, kumbull, vishnje, qershia, kajsia, pjeshka ,ftoni dhe pemë arnore, arra, lajthia)	96	140	349	295	458	-
3	Spektori vreshtari (rrushit)	80	63	88	55	-	71
4	Spektori -pemë të imëta - manore	405	91	0	0	-	-
5	Spektori i vezëve	23	28	35	18	-	35
6	Spektori i qumështit(lopë qumështore)	219	146	191	136	-	207
7	Spektori i qumështit (dele / dhi)	0	28	53	43	-	41
8	Spektori Pika grumbulluese të qumështit	0	6	5	8	-	5
9	Spektori i mishit –(trashja e viçave)	206	126	138	142	-	155
10	Spektori i mishit-(trashja e zogjëve)	0	37	0	0	-	-
12	GLV-të	13	13	13	12	-	11
13	Spektori depo për ruajtje të perimeve	0	35	66	67	-	102
14	Spektori i mishit – (trashja e derrave)	0	6	9	17	-	17
15	Spektori i pemëve të imëta (dredhëz, manaferrë, boronicë, dhe aronia).	0	70	0	0	-	122
16	Prodhimi ,përpunimi dhe promovimi i mjaltit - Bletari (masa 302.1).	211	189	192	188	227	-

17	Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jo drusorë të malit (302.2)	20	20	0	0	-	-
18	Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara ekonomi familjare	17	42	42	82	55	-
19	Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale	18	44	46	65	80	-
20	Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural	37	42	62	78	-	80
21	Akuakultura /kultivimi i peshkut 302.5	0	0	0	17	-	6
22	Rritja e shpezëve për vezë dhe mishë 302.6	0	0	0	51	128	-
23	Ujitja e tokave bujqësore	17	12	13	10	11	-
24	Përpunimi dhe marketingu (masa 4) (103) Sektori i përpunimit të qumeshtit i mishit pemëve dhe perimeve dhe prodhimtaria e verës.	84	70	70	57	65	-
25	Programi i Veçantë - Integrimet Socio- Ekonomike	0	0	0	813	-	-
26	Programi i veçantë –infrastruktura rurale dhe zonat më pak të zhvilluara	0	0	130	0	-	-
TOTALI		1715	1448	1775	2433	1388	861

2249

Tabela 26 Numri i aplikacioneve në PZHR gjatë viteve (sipas sektorëve përkatës) 2016-2020/21




Grafikoni 17 Numri i aplikacioneve në PZHR gjatë viteve 2016-2020/21

Nga të dhënat në tabelën/grafikonin më lartë nr. më i lartë i aplikuesve për PZHR-në ishte në vitin 2019 (2433 aplikacione), në vitin 2020/21 thirrja e parë dhe e dytë 2249, në vitin 2018 (1775 aplikacione), ndërsa në vitet tjera numri i aplikacioneve ishte më i vogël në krahasim me vitet e lartë përmendura.

Tabela krahasuese mbi vlerën e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2016-2017-2018-2019 dhe 20/21. Në tabelën e mëposhtme është shprehur në formë tabelare dhe grafike vlera e mjeteve të kërkuara për sektor të cilët janë të paraparë me PBZHR-në, siç shihet vlera e mjeteve të kërkuar në sektorët përkatës ndryshon nëpër vite përkatëse.

Nr .	Nen – Masat/sectorët	2016	2017	2018	2019	2020/21 Thirrja e parë	2020/21 Thirrja e dytë
1	Sektori serra -duke përfshi patatet	20,356,073.20	16,898,669.78	17,145,515.03	14678361.13	16982261.11	-
2	Depo për ruajtje të perimeve	2,536,919.58	3,098,180.28	5,604,318.53	4799827.03	-	6,442,093.52
3	Sektori i pemëve drufrutore(molla, dardha ,kumbulla ,vishnja, qershia, kajsia, pjeshka ,ftoni) dhe pemë arvore (arra, lajthia)	6,970,694.98	11,428,225.85	29,547,772.60	20286818.69	29,891,218.43	0
4	Sektori vreshtari -rrushit	1,413,465.71	1,648,498.80	2,996,345.32	3266290.50	0	3,719,238.70
5	Sektori pemëve manore (dredhëza mjedra, manaferra dhe boronica)	24,047,050.90	5,343,849.80	0	0	0	7,148,309.89
6	Sektori i vezëve	1,831,242.40	2,288,008.60	3,037,206.99	1403658.90	0	3,119,579.52
7	Sektori i qumështit(lopë qumështore)	14,084,277.62	12,579,465.63	14,252,797.49	11534479.93	0	13,261,356.68
8	Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	3,024,572.69	1,997,731.55	4,100,129.90	2945626.71	0	2,787,957.76
9	Sektori i pikave grumbulluese të qumështit	0	568,061.07	396,390.56	686369.13	0	325,692.60
10	Sektori i mishit- (trashja e viçave)	15,219,485.03	12,154,268.63	10,917,127.69	10426486.36	0	10,507,505.42
11	Sektori i mishit –(trashja e brojlerëve)	4,901,501.91	3,465,255.73	0	0	0	0
12	Sektori i mishit –(trashja e derrave)	0	447,885.08	633,790.50	942382.14	0	1,082,259.01
13	GLV-të	83,790.00	78,240.00	295,882.00	267712.00	0	251,378.30
14	Bletari –prodhimi i mjaltit(302.1)	4,341,415.48	4,112,407.69	3,641,943.78	3782960.05	4,411,007.63	0
15	Grumbull për Fruta mali, jodrusore mali	513,690.20	559,903.10	0	0	0	454,256.66
16	Përpunim në fermë ekonomi familjare	507,927.97	1,182,399.43	1,200,112.61	1722837.97	1,092,960.41	0
18	Aktivitetet Artizanale	429,025.95	1,069,999.46	1,188,045.65	1938342.04	2,367,811.93	0
17	Zhvillim i turizmit rural	1,799,801.81	2,126,310.83	3,097,961.75	3814483.96	0	3,978,536.48
18	Akuakultura /peshku	0	0	0	838582.57	0	300,000.00
19	Rritja e shpezëve për vezë dhe mishë	0	0	0	1012836.98	2,696,700.83	0
20	Ujitja e tokave bujqësore	2,285,771.19	1,858,062.67	2,416,388.66	1842289.82	2,140,451.07	0
21	Përpunimi i qumështit (103)	4,505,745.63	3,598,026.10	3,263,564.60	3418150.66	2,892,343.23	0
22	Përpunimi i mishit	9,665,863.71	7,334,288.46	6,174,604.48	5047135.92	5,053,440.10	0
23	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	14,890,799.06	12,118,962.63	15,559,831.06	10195348.84	12,389,553.33	0
24	Përpunimi i verës	1,366,606.00	2,194,158.00	2,987,955.02	1768838.00	2,867,677.40	0
25	Programi i veçante /inf zona rurale	0	0	17,037,695.04	0	0	0
26	Programi i veçant / integrim socio ekonomike	0	0	0	8993239.48	0	0
	TOTALI	134,780,671.02	112,340,880.33	145,495,379.26	115,613,018.81	82785425.47	53,378,164.54
						136,163,590.01	

Tabela 27 Vlera e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2016-2020/21



Grafikoni 18 Vlera e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2016-2020/21

Nga të dhënat në tabelën/grafikonin më lartë vlera më e lartë e aplikuar për PZHR-në ishte në vitin 2018 (145,495,379.26 €), në vitin 2020/21 (136,163,590.01), ndërsa në vitet tjera vlera e aplikuar ishte më e vogël në krahasim me vitet e lartë përmendura.

Duhet cekur se numri i perfutueve të përkrahur për Projektet e Zhvillimit rural ka pasur rritje por edhe ramje nga viti në vit duke u bazuar në numrin e aplikuesve por edhe në buxhet.


Numri i projekteve të përkrahura sipas viteve 2016-2017-2018-2019 dhe 2020/21 është paraqitur sipas tabelës në vijim:

Tabela 22 – Numri i projekteve të miratuara gjatë viteve 2016-2020/21

Nr.	Nen – Masat/sektoret	2016	2017	2018	2019	2020/21 Thirrja e parë	2020/21 Thirrja e dytë
1	Spektori serra -duke përfshirë patatet	61	78	109	89	117	0
2	Depo për ruajtje të perimeve	13	12	29	14	0	0
3	Spektori i pemëve drufrutore(molla, dardha ,kumbulla ,vishnja, qershia, kajsia, pjeshka ,ftoni)	54	54	66	75	72	0
4	Pemë arnore (arra, lajthia)	0	0	0	0	28	0
5	Spektori vreshtari -rrushit	61	21	18	15	0	0
6	Spektori pemë të imëta (dredhëza, mjedra, manaferra dhe boronica)	52	49	0	0	0	0
7	Spektori i vezëve	6	6	4	6	0	0
8	Spektori i qumështit(lopë qumështore)	34	31	71	35	0	0

9	Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	14	11	25	11	0	0
10	Sektori i pikave grumbulluese të qumështit	0	4	2	2	0	0
11	Sektori i mishit- (trashja e viçave)	34	32	54	47	0	0
12	Sektori i mishit –(trashja e brojlerëve)	10	12	0	0	0	0
13	Sektori i mishit –(trashja e derrave)	0	4	5	9	0	0
14	GLV-të	12	0	13	12	0	0
15	Bletari –prodhimi i mjaltit(302.1)	55	48	63	72	56	0
16	Fruta mali, kërpudha	7	7	0	0	0	0
17	Përpunim në fermë	10	12	33	24	18	0
18	Artizanale	8	12	18	18	14	0
19	Zhvillim i turizmit rural	14	10	16	7	0	0
20	Akuakultura /kultivimi i peshkut	0	0	0	10	0	0
21	Rritja e shpezëve për vezë dhe mishë	0	0	0	19	37	0
22	Ujitja e tokave bujqësore	7	1	3	2	1	0
23	Përpunimi i qumështit (103)	4	0	4	1	2	0
24	Përpunimi i mishit	7	0	3	1	4	0
25	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	11	2	16	4	10	0
26	Përpunimi i verës	3	3	4	1	4	0
27	Programi i veçantë –infr. dhe zonat rurale	0	0	62	0	0	0
28	Masa socio-ekonomike	0	0	0	Është pezulluar kjo thirrje	0	0
	TOTALI	477	409	618	473	363	0

Tabela 28 Numri i projekteve të miratuar gjatë viteve 2016-2020/21



Grafikoni 19 Numri i projekteve të përkrahura sipas viteve 2016 -2020/21

Nga të dhënat në tabelën/grafikonin më lartë numri më i lartë i projekteve të përkrahura për periudhen kohore 2016-202/21 ishte viti 2018 me gjithsej 618 projekte të përkrahura, pastaj 477 në vitin 2016, 474 përfitues të mundshëm në vitin 2019 , 409 përfitues të mundshëm në vitin 2017 dhe 363 përfitues të mundshëm në vitin 2020/21.

Disa nga veshitirësit e hasura gjatë zbatimit të PZHR -2020/21

1. Stafi i limituar në DMPZHR sidomos në kohën intenzive të kontrollës administrative vlerësimit dhe miratimit të PZHR-së.
2. Vonesat në aprovimin e Programit për Zhvillim Rural , shpallja e thirrjes për aplikim të cilat po e zvogelojnë kohën e kryerjes së investimeve dhe po e rritin tej mase volumin e punës për një periudhë të shkurtër kohore.
3. Numri i madh i aplikuesve në disa sektorë te masa 101 (serra, pemë drufrutore dhe pemë arrore), te masa 302 (prodhimi i mjaltit dhe rritja e shpezëve për prodhimin e vezëve)
4. Numri i madhë i kontrolleve (administrative dhe profesionale) brenda vitit kalendarik.
5. Gjendaje me pandemi COVID 19 .
6. Sistemi për menagjimin e granteve jo funksional sa duhet mangësi në disa faza të procesit.

Drejtoria e Autorizimit të Pagesave

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet aktivitetet e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave për Programin e Zhvillimit Rural për vitin 2020/2021 (në vazhdim DAP), për periudhën kohore janar-dhjetor 2021.

Raporti i punës së DAP-së për vitin 2020/2021, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi dhe miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i DAP me Drejtorit e AZHB-së dhe institucionete tjera si MBPZHR, Komunat, ARDP, fermerët përfitues dhe institucione tjera.

Po ashtu, në raport janë paraqitur edhe të dhëna për aktivitetet e zhvilluara për zbatimin e procedurave të parapara ligjore sipas legjislacionit në fuqi e sidomos të kriteve të parapara sipas Udhëzimit Administrativ për PZHR-në 2020/2021 me nr. 02/2020 dhe plotësim-ndryshimit të U/A 02/2020 me U/A 08/2021.

Edhe gjatë këtij viti DAP ka hasur në vështësi të natyrave të ndryshme lidhur me zbatimin e procedurave të parapara (vonesa në Autorizim), marrë parasysh vitin pandemik, mungesa të theksuara të stafit të nevojshëm për zbatim më efikas të programit, disfunktionalizim i tërësishëm i sistemit për menaxhimin e granteve –modulit të Autorizimit të Pagesave, paqartësi dhe mangësi në U/A lidhur me afatet e zbatimit të projekteve dhe problemet në furnizim dhe finalizim të projekteve nga ana e përfituesve si pasojë e rritjes së çmimeve të imputeve të përdorura për zbatimin e projekteve dhe vështësi në furnizim sidomos me pajisje dhe mekanizim bujqësor si dhe probleme tjera.

Gjatë vitit në DAP kanë qenë të angazhuar nga 4 deri në 10 zyrtar në periudha të ndryshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Numri ma i madh i zyrtarëve të ardhur në DAP është trajnuar para se të angazhohet në proces të Autorizimit të pagesave nga stafi me përvojë dhe për një kohë të konsideruar ka marrë pjesë në cilësinë e ndihmësit-vezhguesit gjatë autorizimit të projekteve deri në aftësim të tyre për të punuar të pavarur në këtë proces.

Përveq në proces të Autorizimit stafi profesional i DAP ka zhvilluar edhe aktivitete tjera të ndërlidhura me punët dhe detyrat e AZHB-së, si pjesëmarrje në komisione profesionale, mbështetje për drejtorit tjera të cilat kanë pasur volum më të madh të aktiviteteve, pjesëmarrje në trajnime dhe vizita studimore.

Para fillimit të procesit të autorizimit për programin e vitit 2020 janë organizuar dhe mbajtur trajnime me zyrtarë regional për secilën masë dhe nënmasë me qëllim të sqarimit të procedurave të autorizimit, dokumentacionit të nevojshëm, afatet e implementimit dhe qështje të tjera të identifikuar si pengesë për shmangien e gabimeve eventuale e si pasojë edhe vonesat në Autorizim dhe ekzekutim të pagesave. Duke u bazuar në vonesat në shpallje, miratim të projekteve dhe pengesave të tjera teknike, DAP ka aritur që me sukses të përmbyll vitin 2021 duke autorizuar të gjitha kërkesat për pagesë të cilat kanë kaluar procedurat e nevojshme për autorizim, përjashtoj projektet të cilat kanë pasur paqartësi apo ndonjë pengesë tjetër në aspektin administrativ.

Aktivitetet e realizuara për autorizimin e pagesave

Gjatë vitit 2021 janë realizuar aktivitetet e planifikuara bazuar në planin e punës për vitin 2021 i hartuar pas miratimit dhe kontraktimit të projekteve nga drejtoria e miratimit. Ky plan i autorizimit ka pasur

devijime të vogla për arsye të vitit pandemik, kërkesave të fermerëve për zgjatje të afatit të implementimit të projekteve për arsye të pengesave të shkaktuara nga kushtet e pa përshtatshme atmosferike por edhe pengesave të theksuara në furnizim me impute të nevojshme për implementimin e projekteve të përfituara si mbështetje publike.

DAP-i i AZHB-së ka zbatuar të gjitha kërkesat ligjore të dala nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe U/A për zbatimin e Masave të përkrahura gjatë këtij viti.


Autorizimi i projekteve nga vitet paraprake të mbetura obligime të kontraktuara

Edhe gjatë vitit 2021 janë autorizuar një numër i projekteve të kontraktuara në vitet paraprake të cilat kanë pasur shtyrje të afateve të implementimit apo (vendime nga komisionet e ankesave, vendime të gjykatave), apo ndonjë arsye tjetër.

Nga obligimet e deklaruara nga vitet paraprake me gjithësej 58 projekte dhe vlerë totale prej 2,637,914.88 euro të bartura në vitin 2021 janë autorizuar dhe ekzekutuar të gjitha projektet të cilët kanë parashtruar kërkesë në afat, kanë plotësuar kriteret e parapara ligjore (sipas U/A të vitit përkatës) përkatësisht 21 projekte me vlerë totale prej **773,881.56 €** kurse të tjerat janë refuzuar ose nuk kanë parashtruar kërkesë për pagesë.

Autorizimi i projekteve nga obligimet nga viti 2016,2017 dhe 2019		
Masa	Nr. I projekteve	Vlera e projekteve
101	7	367,204.70
103	3	237,378.39
302	1	8822.24
Ujitja e tokave Bujqësore	1	80,000.00
GLV	9	20,205.23
Nga vitet 2016,2017	2	60,271.00
Totali	23	773,881.56

Tabela 29 Autorizimi i obligimeve



Grafikoni 20 Autorizimi i obligimeve

Autorizimi i projekteve nga programi 2020/2021

Nga programi i vitit 2020/2021 projekte të cilat për arsye të kohës së nënshkrimit të kontratave dhe hartimit të programit dy vjeçar, asnjë nga projektet e miratuara nuk janë autorizuar në vitin 2020 për arsye se afati për implementimin e këtyre projekteve ka filluar nga 16.02.2021.

Procesi i autorizimit të kërkesave për avans dhe kërkesave për pagesë ka filluar pasi janë krijuar kushtet për këtë.

Faza e parë e implementimit të programit 2020/2021 ka filluar me autorizimin e avanceve për të gjithë ata përfitues që e kanë parashtruar kërkesën për avancë.

Masa	Nen Masa	Nr. i Aplikacioneve të Miratuara	Vlera e Aplikacioneve të Miratuara
MASA 101: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	101.1 Pemë drufrutore	72	2,991,028.93
	101.1.1 Pemë arrore (arra, lajthia)	28	1,003,719.10
	101.2.1- Sektorin e perimeve dhe serrave	117	3,143,879.35
	101.2. Pemë manore	0	0.00
	101.2.2-Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	0	0.00
	101.3.1- Prodhimi i mishit/rritja e viçave	0	0.00
	101.3.2- Prodhimi i mishit/rritja e derrave	0	0.00
	101.4.1- Prodhimi i qumështit /lopë	0	0.00
	101.4.2- Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	0	0.00
	101.4.3- Pikat grumbulluese të qumështit	0	0.00
	101.5- Prodhimi i rrrushit	0	0.00
	101.6. Prodhimi i vezëve	0	0.00
			217
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	103.1 Përpunimi i qumështit	2	385,553.00
	103.2 Përpunimi i mishit	4	735,393.00
	103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	10	1,768,491.00
	103.4 Prodhimi i verës	4	799,800.00
			20
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	302.1. – Prodhimi i mjaltit	56	653,108.95
	302.3. – Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi	19	243,712.30
	302.4. – Zhvillimi i aktiviteteteve artizanale	14	267,574.57
	302.7. - Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	37	475,539.25
	302.2. – Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i	0	0.00
	302.5. – Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural	0	0.00
	302.6. - Akuakultura/kultivimi i peshkut	0	0.00
			126
Masa 303 -"Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja Leader"-	"Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja Leader"-	0	0.00
		0	0.00
Masa për ujitjen e tokave bujqësore	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	1	160,000.00
		1	160,000.00
Totali:		364	12,627,799.45

Tabela 30 Numri i projekteve të miratuara për programin 2020/2021


Siç shihet nga Tabela nr. 2, gjatë vitit 2020 janë miratuar dhe kontraktuar 364 projekte nga masat dhe nënmasat të cilat janë të paraqitura në tabelë, kurse nënmasat tjera nuk janë kontraktuar.

Nga këto projekte të miratuara janë autorizuar këto projekte shih tabelën.


Masa	Nen Masa	Nr. i Aplikacioneve të Autorizuara	Vlera e Aplikacioneve të Autorizuara
MASA 101: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	101.1 Pemë drufrutore	56	2,035,041.98
	101.1.1 Pemë arrore (arra, lajthia)	21	695,407.41
	101.2.1- Sektorin e perimeve dhe serrave	108	2,900,104.23
	101.2. Pemë manore	0	
	101.2.2-Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	0	
	101.3.1- Prodhimi i mishit/rritja e vëçave	0	
	101.3.2- Prodhimi i mishit/rritja e derrave	0	
	101.4.1- Prodhimi i qumështit /lopë	0	
	101.4.2- Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	0	
	101.4.3- Pikat grumbulluese të qumështit	0	
	101.5- Prodhimi i rrushit	0	
	101.6. Prodhimi i vezëve	0	
		185	5,630,553.62
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	103.1 Përpunimi i qumështit	2	192,776.50
	103.2 Përpunimi i mishit	4	367,696.50
	103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	7	632,644.50
	103.4 Prodhimi i verës	4	497,913.60
		17	1,691,031.10
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	302.1. – Prodhimi i mjaltit	45	521,213.70
	302.3. – Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi	17	205,611.58
	302.4. – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	10	185,620.68
	302.7. - Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	23	291,552.95
	302.2. – Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i	0	
	302.5. – Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural	0	
	302.6. - Akua kultura/kultivimi i peshkut	0	
		95	1,203,998.91
Masa 303 -“Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja Leader”-	“Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja Leader”-	0	
		0	
Masa për ujitjen e tokave bujqësore	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	1	80,000.00
		1	80,000.00
Totali:		298	8,605,583.63

Tabela 31 Numri dhe vlerat e autorizuara sipas Masave, viti 2020/2021

Në vazhdim po i paraqesim të dhënat e projekteve të miratuara dhe autorizuara sipas masave përmes grafikave për krahasim të tyre për të pasur një pasqyrë më të qartë.




Grafikoni 21 Numri i projekteve të miratuara dhe autorizuara për Masën 101, viti 2020




Grafikoni 22 Vlerat e miratuara dhe të autorizuara për Masën 101, viti 2020

Nga tabelat e bashkangjitura shihet se numri i projekteve të autorizuara për masën 101 ka arritur në 185 apo 85.52 % nga 217 projekte të miratuara dhe të kontraktuara, pjesa tjetër e projekteve të kontraktuara janë në proces të autorizimit, kanë afat për implementim nga se janë miratuar pas procesit të ankimimit, janë refuzuar apo nuk kanë parashtruar kërkesë për pagesë. Gjatë vitit vijues do të vazhdohet me procedimin e projekteve të mbetura, për ata që kanë parashtruar kërkesa për pagesë, apo kanë afat për implementim, do të vazhdohet me autorizim, kurse ata që nuk kanë parashtruar kërkesë për pagesë brenda afatit apo janë refuzuar do të vazhdohet me procedurat e ankimimit.



Grafikoni 23 Numri i projekteve të miratuara dhe autorizuara për Masën 302 -2020/2021



Grafikoni 24 Vlerat e miratuara dhe autorizuara për Masën 302-2020/2021


Në të njëjtën kohë me autorizimin e masës 101 janë autorizuar edhe të gjitha kërkesat e ardhura për Pagesë për Masën 302. Nga tabela dhe grafikoni i paraqitur shihet se nga numri total i projekteve të miratuara dhe kontraktuara prej 126 projekteve në 4 nënmasa janë autorizuar gjithësej 95 projekte apo 75.40 % e projekteve të miratuara.

Fermerët e kontraktuar në të gjitha masat gjatë këtij viti kanë parashtruar numër të madh të kërkesave për shtyrje të afatit, përtej afatit të lejuar me U/A 02/2020 dhe një numër i konsideruar i tyre për arsye shpesh edhe të arsyeshme nuk kanë mundur ti implementojnë projektet e miratuara, e si pasoj ju është shkëputur kontrata apo janë refuzuar. Deri në momentin kur po raportojmë janë gjithësej 21 projekte të refuzuara, numër që mund të rritet në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm.


Përveq autorizimit të pagesave për kërkesat e parashtruara për këto dy Masa (101, 302 dhe 103), 20 përfitues pas nënshkrimit të kontratave me AZHB-në kanë parashtruar kërkesa për paradhenie

(avanc) të cilat janë autorizuar e të cilat nuk kanë parashtruar kërkesë për pagesë të kështit të dytë apo janë refuzuar (kanë humbur afatin e implementimit të projektit apo kanë ende afat për implementim).

Vlera e autorizuar e këtyre 19 kërkesave për paradhënie është **330,141.62 €**, vlerë kjo në total për dy masat (101 dhe 302) dhe një projekt i masës 103.



Grafikoni 25 Numri i projeteve të miratuara dhe autorizuar Masa 103, viti 2020/2021




Grafikoni 26 Vlerat e projeteve të miratuara dhe autorizuar Masa 103, viti 2020/2021


Projektet e Masës 103 për arsye të afatit ma të gjatë të implementimit nuk kanë arritur të autorizohen vlerat e kështit të dytë për arsye se një numër i konsideruar i tyre kanë parashtruar kërkesa për zgjatjen e afatit të implementimit të projekteve me arsyetimin se kanë vështësi në implementim, për arsye të vitit pandemik, ngritjes së çmimeve të makinerisë për përpunim apo pengesave të tjera.

Nga numri total i projekteve të miratuara për këtë masë është autorizuar një projekt, një është refuzuar, një është pezulluar, një është tërheq nga kontrata, 4 në proces të autorizimit dhe të tjerët kanë Aneks Kontrata deri në fund të muajit shkurt të vitit vijues. Siç do të vëreni në tabelën e obligimeve të bartura në vitin 2022 mbesin të autorizohen 18 projekte të kësaj mase me vlerë totale prej **1,830,994.50 €** e cila vlerë mund të zvogëlohet gjatë autorizimit të pagesave.

Nga gjithësej 21 projekte të miratuara, prej të cilave një është tërheq nga implementimi i projektit, një që është refuzuar, dhe një i pezulluar 18 projekte nga kjo masë barten për autorizim në vitin 2022. Gjithashtu vlenë të theksohet se vlerat e autorizuara për këtë masë janë shumica pagesë e paradhënies, përjashtojnë një projekt të nënmasës së prodhimit të verës.



Grafikoni 27 Numri i projeteve te miratuara dhe autorizuara Masa 103, viti 2020/2021



Grafikoni 28 Vlerat e projeteve të miratuara dhe autorizuara Masa 103, viti 2020/2021

Një dukuri e vërejtur gjatë këtij viti janë gabimet e shumta në implementim dhe përgatitjen e dosjeve–pakos për pagesë edhe te projektet e masës 103, shmangie nga implementimi i projekteve sipas planit të biznesit dhe kriterëve të përcaktuara me U/A 02/2020 e cila rrezikon që një numër i konsideruar i projekteve të ju zvogëlohen vlerat apo edhe të refuzohen në tërësi.

Në masën e Ujitjes së Tokave Bujqësore nga programi 2020/2021 është vetëm një përfitues me vlerë 160,000.00 €, të cilit ju ka paguar paradhënia prej 50 % të vlerës së miratuar apo 80,000.00 €. I njëjti ka parashtruar kërkesë për pagesë, është analizuar dhe ka devijim nga plani i biznesit. Për të njëjtin është kërkuar mendim profesional nga ekspert të fushës për marrjen e vendimit meritor.

Bazuar në tabelat e përfshira në raport rezulton se gjatë vitit 2021 janë autorizuar në total 314 projekte të vitit 2020/2021 dhe viteve paraprake në vlerë totale prej **9,739,606.81 €**.

Obligimet e kontraktuara: edhe përkundër angazhimit maksimal të të gjithë stafit të Drejtorisë së autorizimit për përmbylljen e procesit të autorizimit për projektet të cilat kanë parashtruar kërkesa për pagesë një numër i tyre nuk ka mundur të autorizohet për arsye të afatit shumë të shkurtër, pas kërkesës për zhvillimin e procedurave të parapara ligjore që një projekt të autorizohet, marrë parasysh se siq u potencua më lartë këtë vit kishte gabime të konsiderueshme teknike në përgatitjen e pakos për pagesë, afat shtesë për përmirsimin e këtyre gabimeve, paqartësi në raportet e kontrollit në vendngjarje të cilat kërkojnë rikontrollë, kontrolli i stërngarkuar në këtë fazë etj.

Gjithashtu duhet potencuar se pas procesit të ankimimit, pas fazës së miratimit kemi pas mbi 50 projekte të miratuara të cilat kanë pasur afat të implementimit të projekteve deri në mesin e dhjetorit dhe nuk kanë arritur të procedohen për autorizim dhe së fundi projektet me aneks kontrata e sidomos masa 103 të cilët kanë të drejtën në këtë afat sipas U/A 02/2020 të cilët kanë afat deri në fund të muajit shkurt 2022 për implementimin e projekteve dhe parashtrim të kërkesave për pagesë.

Obligimet e kontraktuara nga programi 2020/2021 të bartura në vitin 2022			
Masa	Nen Masa	Numri i projekteve	Vlera e Obligimeve të kontraktuara
MASA 101: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	101.1 Pemë drufrutore	6	252,490.80
	101.1.1 Pemë arrore (arra, lajthia)	4	133,999.65
	101.2.1- Sektorin e perimeve dhe serrave	2	54,371.70
	Totali	12	440,862.15
MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	103.1 Përpunimi i qumështit	2	171,776.50
	103.2 Përpunimi i mishit	3	275,946.50
	103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	10	1,083,271.50
	103.4 Prodhimi i verës	3	300,000.00
Totali	18	1,830,994.50	
MASA 302- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	302.1. – Prodhimi i mjaltit	0	0
	302.3. – Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi	0	0
	302.4. – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	0	0
	302.7. - Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	1	6092.45
Totali	1	6092.45	
Masa për ujitjen e tokave bujqësore	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	1	80,000.00
	Totali	1	80,000.00
Totali i Përgjithshëm			2,357,949.10
Obligimet nga programi i vitit 2018			
Programi I Veçant	Investime ne Infrastrukturën Rurale	4	2,000,000.00

Tabela 32 Obligimet e kontraktuara nga programi i vitit 2018 dhe programi i vitit 2020/2021 të bartura në vitin 2022

Numri dhe vlera e paraqitur në tabel si obligime të kontraktuara mund të rritet marrë parasysh procesin e ankimimit të fermerëve në Vendimet për mbeshtetje në rastet kur mund të ofrohen dëshmi pranë komisionit të ankesave për ndonjë vlerë të zvogluar apo ndonjë projekt të refuzuar e për të cilin komisioni vendos të kthehet në rivendosje apo në rikontroll.

Aktivitetet tjera të zhvilluara në drjtorinë e autorizimit

Kërkesa për kthim të mjeteve: Për arsye të refuzimit të kërkesave për pagesë të perfituesve për mos përmbushje të kushteve të kontratës, implementim i pjesëshëm apo devijim nga kontrata, plani i biznesit, mos respektimi i afateve të parapara me kontratë apo arsye tjera, **DAP** ka propozuar ngritjen e procedurave gjygjësore për 5 perfitues të cilët nuk ju janë përgjigjur kërkesës për kthimin e mjeteve të përfituara si paradhënie pas nënshkrimit të kontratave.

Ky aktivitet do të vazhdoj edhe gjatë periudhës së parë të vitit në vijim për të gjithë perfituesit që projektet e tyre janë refuzuar pas përmbylljes së procedurave të parapara administrative (procesit të ankimimit), për të gjithë ata që nuk i kanë zbatuar kriteret e parapara sipas U/A 02/2020.

Shqyrtimi i kërkesave për zgjatje të afatit të implementimit të projekteve të kontraktuara dhe kërkesave të tjera: gjatë vitit në AZHB janë parashtruar 57 ankesa të natyrave të ndryshme, pjesa ma e madhe e tyre në vendimet e autorizimit të pagesave të cilat janë shqyrtuar dhe për një numër të tyre është përparitur përgjigje nga DAP-i, kurse të tjerat janë proceduar për shqyrtim në komisionet përkatëse.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 kemi pasur numër shumë të madh të kërkesave për shtyrje të afatit të implementimit të projekteve të përfituara si mbeshtetje publike. Gjithesëj janë 127 kërkesa të parashtruara për shtyrje të afatit prej të cilave shumica e tyre janë miratuar me plotesim-ndryshimin e U/A 02/2020 me U/A 08/2021 i cili ka mundësuar që projektet e masës 101 dhe 302 të implementojnë projektet e tyre. Gjatë vitit janë shqyrtuar dhe miratuar mbi 50 kërkesa për shtyrje të afatit dhe janë nënshkruar Aneks Kontrata me fermer përfitues.

Gjithashtu gjatë gjithë vitit në DAP ka pasur shumë kërkesa për sqarime të procesit dhe procedurave, andaj stafi i DAP-it një kohë ët konsideruar ka shpenzuar për pritje të paleve dhe sqarimet e nevojshme për fermerët përfitues.

Trajnimi i stafit të DAP-it: bazuar në mungesën e madhe të stafit në DAP, krahasuar me përgjegjësit që dalin nga përkrahimi i detyrave të punës, volumit të madh të punëve, procedura të shumta për autorizim të një pagese në mbeshtetje të BB-së dhe dy zyrtarëve me MSHV janë rekrutuar 6 zyrtarë për drejtori të cilët janë trajnuar për procedurat e parapara sipas legjislacionit në fuqi, gjithashtu për një kohë të konsideruar zyrtaret e rinjë janë bashkangjitur Ekipeve të Autorizimit si vëzhgues për tu trajnuar për shqyrtim të kërkesave për pagesë, analizë të lëndës dhe autorizim.

Në vazhden e bashkëpunimit me ARDP-në është realizuar një visitë studimore në Agjencinë e Pagesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut për 5 zyrtarë të DAP-së për të marrë përvoja në zbatim të procedurave e sidomos procedurat e IPARD-it.

Bashkëpunimi dhe informimi: DAP vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata ndërkombëtare. Gjatë vitit 2021, zyrtarët e DAP-it kanë marrë pjesë në shumë aktivitete edhe jashtë detyrave dhe kompetencave të tyre duke marrë pjesë në grupe punuese për Hartimin

e Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 /2027, grupe punuese në ARDP për shqyrtim të aplikacioneve për grante, komisione për shqyrtim të kërkesave, ankesave dhe aktivitete tjera.

Stafi i DAP-it gjithmonë një vëmendje të veçantë i ka kushtuar informimit të përfituesve për gabimet e mundshme teknike në dosjet e tyre duke ju mundësuar permirsimet e tyre.

Gjatë vitit kemi pasur auditime, 4 auditime nga ZAP dhe AB për të cilat i gjithë stafi i DAP-it ka ofruar pashkëpunim të plotë me dokumentacion dhe shpjegime të nevojshme lidhur me procesin e autorizimit.

Vështirësitë gjatë implementimit të programit 2020/2021

Marrë parasysh se edhe viti 2021 ka qenë vit i pandemisë Covid 19, ka qenë e pritshme që të ketë vështërsi në implementimin e aktiviteteve të planifikuara në kohë nga se kemi pasur shpesh mungesa të stafit për shkak të vetëizolimit dhe mungesës në punë.

Një prej pengesave e cila ka shkaktuar shumë vështërsi në zhvillim të aktiviteteve në DAP ka qenë disfunkcionalizimi i Grant Menaxhmentit- Moduli të Autorizimit i cili ka qenë jashtë përdorimit dhe kjo ka krijuar shtim enorm të punëve dhe vonesa në procesim të kërkesave për pagesë. DAP për mungesë të këti softveri është detyruar të punoi në Word dhe Exel për zhvillimin e procedurave të autorizimit duke përdorur shabllone të krijuara të cilat për arsye të volumit të madh të punëve dhe afateve të shkurta, shpesh kanë prodhuar gabime teknike e si pasojë edhe vonesa në autorizim. Gjithashtu mungesë të konsideruar DAP ka pas edhe në pajisje të TI-së (kompjuter, printer dhe skener) të cilat janë të domosdoshme për aktivitet.

Gjatë analizës së pakos për pagesë për mungesë të kriterëve të qarta në program dhe U/A shkaktohen vonesa në autorizim dhe dilema për marrje të vendimeve, andaj duhet të përgatiten kriterë të qarta dhe të matshme për miratim dhe autorizim, gjithashtu gjatë procesit të autorizimit, sfida në shumë raste ka qenë mungesa e çmimeve për disa artikuj në çmimoren standarde të AZHB-së dhe standardet minimale nacionale për ndërtimin e fermave, depove, objekteve të përpunimit etj.

Një qështje që kërkon vëmendje shumë të madhe është qështja e hartimit të Çmimore Referente të AZHB-së e cila ka mangësi të konsideruara (mungesa e çmimeve referente për shumë artikuj e sidomos te masa 103 dhe 302). Duhet të mendohet për formimin e një trupe (sektori apo divizioni) i cili do të merret me përcaktimin e çmimore referente dhe kjo trup të jetë përmanente. Formimi i një sektori për çmimore do të ndihmoj procesin e miratimit dhe autorizimit në rimbursim të vlerave të sakta për blerje apo shërbime të përfituara me projekte.

Në raport do të paraqesim në vija të trasha vështërsitë e hasura në autorizim por do të përgatitet kërkesë e detajuar për adresim në grupe Punuese për vështërsitë dhe njëkohësisht edhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre.

Mungesa e hapsirës për arkivimin e dosjeve të autorizuar është një pengesë shumë e madhe për menaxhmin e dokumentacionit. Në DAP kanë mbetur numër i madh i dosjeve nga vitet paraprake që shkakton mundësin e përzjerjes së dosjeve dhe vështërsi në identifikimin e tyre. Është kërkesë urgjente të gjendet mundësi për arkivim të dosjeve të cilat kanë përfunduar procedurat e parapara administrative.

Nevojat e DAP-it për vitin 2022

Duke u bazuar në kompleksitetin e procedurave të autorizimit të pagesave është kërkesë permanente me vite që të plotësohet stafi i nevojshëm për zhvillim të aktiviteteve me kohë në mënyrë cilësore dhe me përgjegjësi maksimale. Kjo krijon nevojën për plotësim të DAP-it me staf të nevojshëm dhe profesional. Gjithashtu kjo do të mundësonte ndarjen e qartë të përgjegjësive si në mes të drejtorive po ashtu edhe për brenda drejtorisë së autorizimit të pagesave.

Për të arritur këtë nevojitet plotësim i stafit të drejtorisë deri në 14 zyrtarë të rregullt duke ofruar për ta trajnimet e nevojshme për të zbatuar detyrat e dhe përgjegjësit sipas përshkrimit të vendit të punës.

Nevoja për hartimin e një programi softverik për menaxhimin e procesit dhe zbatimin e procedurave të parapara me qëllim rritjen e efikasitetit në punë, rritjes së saktësisë dhe besueshmerisë në këtë proces, ruajtjen e të dhënave në histori dhe krijimin e mundësisë për krijimin e të dhënave të nevojshme statistikore për sektorët e mbështetur.

Krijimi i këtij softveri do të rris transparencën, do të shtoj kontrollin e brendshëm, do të pamundësoi përfitimin e granteve nga individ apo kompani të njejta për shumë vite apo përfitim të projekteve të ngjashme. Përveç kësaj do të përshpejtohet procesi i autorizimit dhe do të lehtësohet puna e zyrtarëve përgjegjës për këtë proces, duke pasur parasysh se kemi rritje të buxhetit dhe kjo rritje pritet të jetë shumë ma e madhe në vitet në vijim nga buxheti nacional por edhe nga buxheti i IPARD-it apo donatorëve të tjerë.

Pajisja e zyrtarëve me pajisje të TI-së (komjuter, printer, skener etj).

Futja në përdorim e të gjithë formularëve të Pakos për Akreditim me një përshatje kërkesave administrative si LLOGO-ja dhe çështje të tjera teknike.

Jetësimi i një kërkesë të kahëmotshme për menaxhim të dokumentacionit duke protokoluuar dhe skanuar secilën dosje me qëllim të krijimit të dosjeve elektronike të të gjithë dokumentacionit të përdorur në çdo fazë nga aplikimi e deri te ekzekutimi i pagesës si dhe sigurimi i hapsirave të nevojshme për arkivë dhe arkivimi i dosjeve të cilat kanë përfunduar procedurat e parapara administrative.

DREJTORIA E PAGESAVE DIREKTE

Pagesat Direkte për mbjellje vjeshtore – grurë

Pagesat Direkte për mbjellje vjeshtore - grurë kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2021, por me një ndryshim nga vitet e kaluara ku këtë vit subvencionimi për grurë ka qenë i kombinuar për sipërfaqe dhe kilogram të prodhur. Sa i përket sipërfaqeve të mbjella me grurë, viti 2021 është karakterizuar me zvogëlimin të numrit të fermerëve aplikues për grurë, gjithashtu edhe të sipërfaqeve të mbjella krahasuar me vitin 2020.

Siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme, numri i aplikuesve për grurë ka qenë 6,832, me sipërfaqe totale prej 30,428.74 ha, ndërsa sipërfaqja totale e subvencionuar është gjithsej 27,667.79 ha. Kurse shuma e pagesës totale për sipërfaqet e mbjella me grurë për vitin 2021 është 2,076,584.25 €. Në vitin 2020 janë subvencionuar 46,907.50 ha me grurë, që do të thotë se këtë vit kemi zvogëlim të dukshëm të sipërfaqeve të subvencionuara me grurë për 16,478.76 ha ose 31.13 % më pak se sa në vitin 2020.

Numri i aplikuesve të refuzuar pas kontrollës administrative, për mosplotësim të kriterëve apo moskompletim të dokumenteve është 266 fermer apo 3,89% e fermerëve, ndërsa sipërfaqja e refuzuar është 1,180.93 ha ose 3.88 % nga sipërfaqja totale.

Në bazë të plotësim ndryshimit të U/A, sipërfaqet e mbjella me grurë nuk janë kontrolluar në terren për shkak të vonësës së zbatimit të Programit.

Duhet cekur se këtë vitë për herë të parë është bërë edhe subvencionimi i grurit për rendiment ku në bazë të kriterëve të plotsuara dhe vërtetimit mbi dëshminë e prezantuar për grurin e dorzuar në mulli ose pikë grumbulluse janë subvencionuar 3553 përfitues me 62,590,988.12 kg të dorzuar me shumën prej 0.019 cent, ku shuma totale e Kg të dorzuara është subvencionuar në vlerë totale prej 1,183,143.68 €.

Nr	Komuna	Nr. Aplik	Sipër/Aplik	Nr. Refuzuar	Sipër/ Refu	Në Proces	Sipër/ Proces	Nr Përfit	Sipër/ /Krerë Subvencionuar	Paguar €
1	Deçan	63	217.19	1	2.69	-	-	62	204.95	15,371.25
2	Dragash	1	3.09	-	-	-	-	1	3.09	231.75
3	F.Kosovë	149	754.79	-	-	-	-	149	644.77	48,357.75
4	Ferizaj	416	2,218.47	17	67.18	-	-	399	2,009.99	150,749.25
5	Gjakovë	144	900.64	1	2.61	-	-	143	879.84	65,988.00
6	Gjilani	192	679.42	7	16.70	-	-	185	656.08	49,206.00
7	Glllogovc	417	1,711.55	9	27.56	-	-	408	1,642.56	123,192.00
8	Graçanica	303	1,016.84	8	15.62	-	-	295	996.82	74,761.50
9	Hani Elezit	5	14.86	2	4.17	-	-	3	10.69	801.75
10	Istog	195	1,279.44	6	14.59	1	9.31	188	1,123.61	84,270.75
11	Junik	16	45.48	-	-	-	-	16	45.48	3,411.00
12	Kaçanik	23	115.62	2	4.65	-	-	21	110.61	8,295.75
13	Kamenicë	209	723.81	1	2.31	-	-	208	715.32	53,649.00
14	Klinë	275	1,489.12	8	33.88	-	-	267	1,444.54	108,340.50
15	Klllokot	55	190.08	6	15.30	-	-	49	155.71	11,678.25
16	Leposaviq	10	26.01	3	8.47	-	-	7	17.54	1,315.50

17	Lipjan	714	3,233.20	18	73.79	-	-	696	2,945.08	220,881.00
18	M. Veriut	-	-	-	-	-	-	-	-	-
19	Malishevë	372	1,652.40	19	75.03	1	3.13	352	1,491.34	111,850.50
20	Mamushë	25	82.78	1	2.02	-	-	24	80.57	6,042.75
21	Mitrovicë	51	172.11	1	14.92	1	2.41	49	149.77	11,232.75
22	Novoberd	57	178.51	-	-	-	-	57	178.51	13,388.25
23	Obiliq	183	756.21	9	33.47	1	5.64	173	713.63	53,522.25
24	Partesh	63	168.70	4	7.96	1	2.05	58	149.69	11,226.75
25	Pejë	177	1,084.57	10	268.67	-	-	167	745.90	55,942.50
26	Podujevë	435	1,722.50	24	68.14	-	-	411	1,596.23	119,717.25
27	Prishtinë	154	642.43	7	25.85	-	-	147	607.92	45,594.00
28	Prizren	109	609.46	10	70.60	-	-	99	513.06	38,479.50
29	Rahovec	275	1,037.31	8	20.41	2	9.71	265	982.87	73,715.25
30	Ranilluk	8	29.89	-	-	-	-	8	29.89	2,241.75
31	Shterpcë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
32	Shtime	187	773.87	5	22.32	-	-	182	728.35	54,626.25
33	Skenderaj	443	1,978.08	19	58.05	-	-	424	1,858.27	139,370.25
34	Suharekë	277	1,283.33	25	95.92	-	-	252	1,022.45	76,683.75
35	Viti	310	1,455.69	16	81.03	1	2.15	293	1,226.72	92,004.00
36	Vushtri	519	2,181.29	19	47.02	1	3.90	499	2,005.94	150,445.50
37	Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	-	-
38	Zveçan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Total	6,832	30,428.74	266	1,180.93	9	38.30	6,557	27,687.79	2,076,584.25

Tabela 33 Të dhëna për Pagesat Direkte për sipërfaqe të grurit për vitin 2021, sipas komunave

Nr	Komuna	Nr. Aplik	Sipër/Aplik	Nr. Refuzuar	Sipër/ Refu	Në Proces	Sipër/ Proces	Nr Përfit	Sipër/ /Krerë Subvencionuar	Paguar €
1	Deçan	24	243,317.00	-	-	-	-	24	243,317.00	4,623.03
2	Dragash	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	F.Kosovë	90	2,184,859.00	-	-	-	-	90	1,762,664.00	33,490.61
4	Ferizaj	230	6,210,836.00	22	399,219.00	-	-	208	5,496,030.00	104,424.55
5	Gjakovë	88	2,104,207.00	3	28,125.00	-	-	85	1,882,912.00	35,525.75
6	Gjilani	67	1,023,974.00	2	15,350.00	-	-	65	1,008,624.00	19,103.02
7	Glllogovc	153	2,022,937.00	2	14,500.00	-	-	151	1,993,437.00	37,804.21
8	Graçanica	255	3,455,142.00	11	86,623.00	-	-	244	3,310,629.00	62,901.96

9	Hani Elezit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	Istog	86	3,103,294.00	3	97,470.00	-	-	83	2,510,288.00	47,695.48
11	Junik	2	12,640.00	-	-	-	-	2	12,640.00	181.12
12	Kaçanik	16	423,899.00	1	6,967.00	-	-	15	416,932.00	7,921.71
13	Kamenicë	43	520,035.00	-	-	-	-	43	520,035.00	9,880.69
14	Klinë	196	4,376,639.00	3	43,360.00	-	-	193	4,264,825.00	80,821.80
15	Klllokot	21	375,693.00	5	25,055.00	-	-	16	364,785.00	6,930.91
Resurset Tekniko – Logjistike në shërbim të Drejtorisë së Kontrollit shërbejnë për kryerjen e aktiviteteve në terren, vajtjen tek aplikanti, matjen dhe verifikimin e deklarimeve, parcelave, krerëve, fidaneve dhe litrave të tjera dhe konstatimin me saktësi të realizuara në vendngjarje.

Mjetet tekniko-profesionale, në shërbim të Drejtorisë së Kontrollit, në shërbim të kontrollit në terren janë: Sistemi i digjitalizimit dhe kontrollit të parcelave – SLPIS, i cili është funksional në Laptopet e inspektorëve të terrenit me të cilin bëhet identifikimi dhe matja e parcelave dhe krahasimi i hartave.

GPS është mjet pune i cili poashtu shfrytëzohet nga inspektorati në terren për identifikimin, matjen, krahasimin dhe regjistrimin e parcelave të matura , edhe pse këtë vit nuk kemi pas për të verifikuar parcela me grurë, miser, elb, theker, tersherë, por pemishte dhe vreshta, po ato të cilat i ka zgjedhur programi për kontrollë në terren.

Shiritmatësit dhe odometri.

Në shërbim të inspektoratit të terrenit poashtu janë edhe dokumentet e kontrollit si: Blloku i procesverbaleve për Pagesa Direkte, fletëngarkesa me listën e lëndëve për kontrollë si dhe dokumente tjera.

Mjetet logjistike – Automjetet janë pjesë e punës së kontrollit për dalje dhe verifikim në vendngjarje. Vitin e fundit Drejtoria e Kontrollit ka pasur shumë probleme me sigurimin e automjeteve për kontrollë në terren

për arsye se automjetet që i ka në dispozicion Drejtoria e Kontrollit ju skadoj afati i regjistrimit dhe disave prej tyre edhe i servisimit dhe deri me tani është problem i pa zgjidhur, kështu se mbetet të sigurohen automjete nga jashtë, u siguruan një numër i vogël i tyre për kontrollë dhe për verifikim në terren nga APK-ja së bashku me disa zyrtar që i sjellen në ndihmë për kontrollë në terren si dhe ca prej tyre i huazuan nga stafi Politik i MBPZHR-së.



Figure 2. Mjetet Tekniko Profesionale të Kontrollit në terren

Prej mjeteve të tërësishme që disponon Inspektorati i Terrenit për punë në terren kemi këto të dhëna:

1.Lap-Top –sLIPS- 27(Sistem i Vjetër i Ortofotove nga 2012)

2.GPS – 28

5. Automjete –..... 24

Këto mjete janë të shpërndara në shtatë Zyrat Regjionale dhe janë në shfrytëzim nga Ekipet e Kontrollit në terren.

AKTIVITETET E ZHVILLUARA VJETORE

- ❖ **Pas analizës vjetore** të punës dhe nxjerrjes së konkluzioneve lidhur me proceset e realizimit të punëve në vitin paraprak, janë ndërmarrë masat e duhura për eliminimin e dobësive dhe përmirësimin e fushave ku janë shfaqur këto dobësi, si në dokumentacion, në qasjen ndaj Programeve dhe Projekteve, kontrollin fizik në terren etj.
- ❖ Poashtu, është hartuar **Plani Sektorial**. Plani i Sektorit për **Pagesa Direkte**, i cili poashtu përveç analizës së kontrollit nga viti paraprak, përfshirjes së resurseve në dispozicion ka paraparë edhe kornizën kohore të përfundimit të kontrollit për Pagesat Direkte – edhe pse në vitin 2021 filluam me 10.11.2021 ja arritëm për afërsisht ta përfundojmë programin e kontrollit 90%. Brenda një muaji e 20 ditë dhe pjesa tjetër për afërsisht e 10 % vazhdoj të realizohet në fillimin e vitit 2022, gjë e cila varet nga Kontrolli Administrativ-DPD dhe ardhja e lëndëve për kontrollë. Në fakt Normat e Kontrollit të Përcaktuara me UA/07-2021(Plotësim-Ndryshim) dhe Mostrën e përcaktuar për Kontrollë në terren, janë tejkaluar në shumicën e rasteve përveç : Pulat Vojse (nuk kanë ardhur lëndët (si duket ka gabime në numrin e aplikantëve), dhe Bletari – kryesisht problemet me aplikim në Komunitet Veriore që nuk i kanë sjellur lëndët për kontrollë.
- ❖ **Punët Logjistike** - Duke ditur se stafi Logjistik i AZHB-së është i limituar në këtë Sektor të AZHB-së janë përcjellur vetëm shkresat, raportet e automjeteve dhe kërkesat për servisim, kurse punët teknike dhe praktike janë kryer nga inspektorët e kontrollit.
- ❖ **Raportimi**-Gjatë kontrollit të lëndëve për të gjitha nën-masat e Subvencioneve, është bërë praktikë e zakonshme. Si çdo vit me fillimin e kontrollit raportimi bëhet në baza: ditore, javore, mujore dhe vjetore.
- ❖ Poashtu vlenë të ceket pjesëmarrja e stafit në Komisione të ndryshme në kuadër të punëve tjera që i përkasin AZHB-së. Më poshtë përshkruhen në mënyrë të detajuar aktivitete dhe proceset e zhvilluara të kontrollit në terren për sektorin e kontrollit të Pagesave Direkte.

KONTROLLI I LËNDËVE PËR PAGESA DIREKTE

Kontrolli i Masave të Pagesave Direkte-Subvencioneve është një sfidë e madhe sepse tek ne në Kosovë (në mungesë të Sistemit AIA), kontrolli është enorm, krahasuar me vendet tjera të Regjionit dhe më gjerë sepse të gjitha Agjencitë e të njëjtës fushë kontrollin e subvencioneve e bëjnë ose me nënkontraktues ose me % simbolike të kontrollit, duke parë në këtë prizëm ne kontrollin e subvencioneve e kemi tepër të ngarkuar. Duke pasur parasysh çështjen e lartëcekur sa i përket kontrollit në terren të Masave Subvencionuese mund të themi se për vitin 2021 kontrolli ka qenë i realizuar sipas normave të parapara ligjore, ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, UA/07/2021, Programit për Pagesa Direkte-2021 dhe Rregullores së Drejtorisë së Kontrollit për Kontrollin e Pagesave Direkte.

Me korigjimin e UA – 07/2021 për shkak të vonesave për nënshkrimin e Programit që të fillohet me kohë kontrolli dhe i tejkaloj të gjitha normat për kontrollim të të gjitha masave në terren dhe kërkesës të Drejtorisë së Kontrollit që të bëhet korigjimi i UA-së. Ministri i MBPZHR – AZHB -së mori vendim për ndryshimin e tij dhe me nxjerrjen e Vendimit të ri që të kontrollohen vetëm ato kultura apo krerë që shihen: Pemtaria – 5%, Vreshtaria – 5%, LQ, Dele, Dhi – 20%, Viqat për majmeri -20%, Dosat për riprodhim – 50%, Pulat Vojse – 80 %, Bletet – 90 %, Thellenzat-80%, Materiali Fidanor - 80%, Verë e prodhuar-100%.

› **Kontrolli i Pemishteve**

Pemishtet Drufrutore dhe Manore – Gjithësej për kulturat Pemtare kanë aplikuar për vitin 2021: 3574 – fermer gjithsej me sipërfaqe prej 4657.83 – ha, ku në terren në bazë të përqindjes ka qenë dashtë të kontrollohen 179 - fermer ndërsa janë kontrolluar 509 - fermer.

Tek pemishtet programi ka definuar më qartë kriteret e pranueshmerisë kështu që nuk ka probleme të veçanta gjatë kontrollit.

Kontrolli i materialit Fidanor- Materiali fidanor është kontingjent i vogël dhe përvoja e këtyre pesë viteve është bartur te të gjitha ekipet. Kontrolli është kryer 100 %, kanë qenë gjithsejtë 17 aplikantë dhe në kontroll kanë dal 17 aplikant.

Kontrolli i Vreshtave-Tek vreshtat, gjithësej për kulturat Vreshtare kanë aplikuar 2913 fermer, me sipërfaqe totale 3122 ha, ku në bazë të përqindjes së kontrollit prej 5% duhet të kontrollohen 144 fermer, ndërsa janë kontrolluar 194 fermer.

Kontrolli i Verërave –Kanë qenë 17 Aplikues me 919427.29 litra verë, kontrolli është kryer 100%.

› **Kontrolli i Kafshëve – LQ/Buallica ,Dele,Dhi,**

Kontrolli i kafshëve vazhdon si proces, verifikimi sipas kërkesave të Programit Subvencionues duke u bazuar në listat dhe numrat e pronave të përpiluara nga Databaza e Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit. Problemet që paraqiten gjatë kontrollit dhe përcillen për vite të tëra janë: Rënja e numrave të Matrikujve – Matrikujt e dobët, rifreskimi i rrallë i databazes dhe futja e dy-tre pronave të vogla në një kod pronësor. Edhe ky lloj kontrolli tashmë është një rutinë për inspektoratin e Drejtorisë së Kontrollit.

Për **Lopë Qumështi** - kanë aplikuar gjithsejtë 6536 fermer me gjithsej 63456-krerë Lopë Qumshtore – Buallica, përqindja e kontrollit në bazë të mostrës është përcaktuar 20%, ku në terren është dashtë të kontrollohen 1271 fermer, ky numër është tejkalluar me 478 aplikant më tepër.

Për **Dele Qumështi** - kanë aplikuar gjithsejtë 1183 fermer, me gjithsej 146018 krerë Dele,ku në terren është dashtë të kontrollohen 236 fermer por janë kontrolluar 405.

Për **Dhi Qumështi** - kane aplikuar gjithsejtë 284 fermer me gjithsej 17758 krerë Dhi, kontrollit është dashtë të i nënshtrohen 57 fermer me përqindje 20% të numrit total, ndërsa janë kontrolluar 111.

Për **Dosa për riprodhim** - kanë aplikuar gjithsejtë 158 fermer me gjithsej 1390 Dosa për riprodhim, përqindja e kontrollit të dosave për riprodhim është 50%, ku është dashtë të kontrollohen 79 fermer dhe janë kontrolluar 101 fermer.

Kontrolli i Bletëve –Numri total i aplikuesve për bletë është 3369 fermer me gjithsej 220082 Koshere Bletë ,ku përqindja e kontrollit është 90 % dhe është dashtë të kontrollohen 3032 fermer, dhe janë kontrolluar 2928 fermer me bletë .Arsyeja e mospërmbushjes së përqindjes së kontrollit te Bletaria është sepse 3 komunat e pjesës veriore të Mirovicës (Albanik,Zubin Potok dhe Zveqan nuk kanë kaluar Administrativisht për shkak të defekteve të tyre gjatë aplikimit dhe komplet këto 3 komuna i janë nënshtruar një komisioni në kuadër të MBPZHR-AZHB-së, dhe nëse komisioni jep një sinjal pozitiv për ti pranuar në kontroll në terren këto aplikacione atëherë edhe përqindja e kontrollit te Bletaria plotësohet dhe tejkalohe.

Kontrolli i Pulave Vojse dhe Thëllënzave–Numri total i aplikuesve për Pula Vojse – 97 (që nuk duket shifër e saktë ose Kontrolli Administrativ akoma nuk i ka identifikuar), janë kontrolluar 80 aplikant për 17

nuk kemi të dhëna (derisa Kontrolli Administrativ të definojë numrin e sakt). Thëllënza -12 aplikant është realizuar 100%. Arsyeja e mosplasimit në terren mund të jetë edhe refuzimi nga Kontrolli Administrativ.

Tabela e qarkullimit të lëndëve në terren për Pagesa Direkte-2021- Sipas Aplikacioneve

Komunat	Të pranuar a Total	Janë kthyer pa Raporte (Sipërfaqe)	Për Kontroll ë në terren - 2021	Numri i Lëndëve të përfunduar a	%	Numri I Lëndëve të mbetura për kontroll ë	Numri i Lëndëve të kthyer tek DPD
PRISHTIN Ë	344	51	293	293	100	0	344
Podujevë	481	210	270	270	100	0	481
Lipjan	202	55	147	147	100	0	202
Drenas	161	28	133	133	99.25	0	161
F. Kosova	132	68	64	64	100	0	132
Obiliq	96	25	71	71	100	0	96
Graçanicë	67	16	51	50	98.04	1	66
TOTALI	1482	453	1029	1028	99.81	1	1482
Mitrovicë	264	59	205	205	100	0	264
Skenderaj	569	234	335	335	100	0	569
Vushtrri	539	243	296	296	100	0	539
Leposaviq	47	2	45	45	100	0	47
Zveçan	13	5	8	8	100	0	13
Zubin Potok	73	0	73	73	100	0	73
Mitrovicë e Veriut	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	1505	543	962	962	100	0	1505
GJILAN	333	127	206	206	100	0	333
Kamenicë	224	16	208	208	100	0	224
Viti	146	7	139	139	100	0	146
Novo Berd	222	123	99	99	100	0	222
Pertesh	31	6	25	25	100	0	31
Ranilluk	30	0	30	30	100	0	30
Kllokot	24	0	24	24	100	0	24
TOTALI	1010	279	731	731	100	0	1010
PEJË	363	24	339	339	100	0	363

Istog	259	16	243	243	100	0	259
Klinë	160	14	146	146	100	0	160
TOTALI	782	54	728	728	100	0	782
FERIZAJ	218	17	201	201	100	0	218
Shtime	82	18	64	64	100	0	82
Kaçanik	99	2	97	97	100	0	99
Shterpcë	70	6	64	64	100	0	70
Hani Elezit	42	4	38	38	100	0	42
TOTALI	511	47	464	464	100	0	511
PRIZREN	222	12	210	210	99.52	0	221
Suharekë	188	5	183	183	100	0	188
Malishevë	363	163	200	200	100	0	363
Dragash	126	0	126	126	100	0	126
Mamushë	9	1	8	8	100	0	9
TOTALI	908	181	727	727	99.86	0	907
GJAKOVË	278	5	273	273	100	0	278
Rahovec	308	42	266	266	100	0	308
Deçan	216	41	175	175	100	0	216
Junik	35	10	25	25	100	0	35
TOTALI	837	98	739	739	100	0	837
Subtotali	7035	1655	5380	5379	99.94	1	7034

Tabela 66 Qarkullimi i lëndëve të Pagesave Direkte gjatë vitit 2021

Nr	Lloji i Masës për Subvencionim	Numri i Aplikantve sipas Masës	Numri i Kontrollave të realizuara	% e Kontrollit e arritur ne terren	% e Kontrollit sipas UA
1	Pemtaria	3574	509	14.24 %	5 %
2	Vreshta	2913	194	6.66 %	5 %
3	Lopë Qumështi	6536	1748	26,76 %	20 %
4	Dele	1183	405	34,23 %	20%
5	Dhi	284	111	39.08 %	20 %
6	Dosa	158	101	63.92 %	50 %
7	Bletë	3369	2928	86.91 %	90 %
8	Pula vojse	97	80	82.47 %	80 %
9	Fidane	17	17	100 %	80 %
10	Thëllënza	12	12	100 %	80 %
11	Verëra	17	17	100 %	100 %
12	Viça	148	282	38.42	20%

Tabela 67 Numri i Aplikantëve për Pagesa Direkte, Numri i Aplikantëve të Kontrolluar dhe shprehja në % e kontrollit


Norma - 100%	Numri i Fermerëve i paraparë 100 %	%	Apl.Total	Të Kontrolluar	%	Fermer të mbetur për kontrollë deri në përfundimin e normës	Fermer të kontrolluar mbi normë
Mbi -- 5Ha	131	3.66	3574	509	14.24		320
4 -- 694 -- Ha	57	2	2913	194	6.66		50
15 - Mbi 200-983	874	13,76	6536	1749	26.76		478
200-430	236	16,51	1183	405	34.23		169
200 - 430	12	4.23	284	111	39.08		54
40 - Mbi 100 - %	2165	64.26	3369	2928	96.57	104	S'kan ardhur lëndët
100 - %	97		97	80	82.47	17 - ?	Gabim Aplikimi
100 - %	12		12	12	100.00		0
100 - %	17		17	17	100.00		0
10 - Mbi 100 - %	47	29.74	158	101	63.92		22
100 - %	17		17	17	100.00		0
30 - 115	45	6.13	734	282	38.42		134
	3710		18894	6405	33.90	107	1227

Tabela 68 Normat e parapara 100% për kontrollë sipas Mostrës dhe realizimi i kontrollit në totalin e Aplikantëve të paraparë për kontrollë

(Vërejtje: Në tabelën No-7, Numri i Aplikantëve total paraqet vetëm numrin total të Apliantëve që janë përzgjedhur për kontrollë e jo të gjithë aplikantët, (bletët, përzgjedhja për kontrollë 90 %, ose në numër : 3032 për tu përmbushur norma kanë mbetur edhe 104 aplikant).

Viti	Numri i Kontrolleve për Aplikant	Numri i Kontrolleve të realizuara për Masa
2013	16556	
2014	18745	
2015	20171	
2016	19370	32098
2017	13094	23476
2018	11162	20852
2019	10341	18639
2020	10901	20006
2021	7049	8058

Tabela 69 Ne mënyrë tabelare po i paraqesim numrin e kontrollave nëpër vite prej vitit; 2013 – 2021.



Grafikoni 31 Tregon uljen e kontrollit për Aplikant dhe rritjen e kontrollit për Masa / Kultura
Paraqitja krahasuese e kontrollit nga viti 2013 - 2021



Figure 3. Insete nga kontrolli i Pagesave Direkte

Ex-Post Kontrolli

Kam qenë i ngarkuar si mbikqyrës i Ex-Post Kontrollit dhe në fillim të këtij viti kemi kryer Ex – Postin e përfituesve të vitit 2018 dhe gjithsej në kontrollit i'u kanë parashtruar 551 fermerë që ishin përfitues në vitin 2018.

Raportimi

Gjatë kontrollit të lëndëve për Pagesa Direkte në përgjithësi është bërë praktikë e zakonshme që çdo ditë në orët e mëngjesit të verifikohet dalja e inspektorëve në terren atëherë kur ka kontrole, numri i lëndëve në posedim të ekipit, zona e kontrollit (sepse mund të ndryshoj për çdo ditë situata), kurse të nesërmen secili përgjegjës i zyrës ka për detyrë përmes Emailit ose përmes telefonit nëse nuk i funksionon rrjeti ti përcjellin të dhënat e kontrollit në Qendër në Sektorin e Kontrollit për çdo ekip, të dhënat për numrin e fermerëve dhe numrin e kontroleve të kryera dhe problemet e mundshme, ndërsa ne së bashku me dy zyrtarët që i kemi në Sektorin e Kontrollit të Pagesave Direkte si çdo vit me fillimin e kontrollit raportimi bëhet në baza ditore – kur fillon kontrolli javor në terren nga një herë edhe tre mujor. Raportimi, monitorimi dhe evidentimi i përditshëm i të dhënave nga kontrolli në terren është një punë shumë e ngarkuar dhe mjaft e komplikuar sepse krijimi i databazës (planeve operative të kontrollit), qarkullimit të lëndëve, dalje-kthim nga terreni është një punë shumë e ngarkuar duke pasur parasysh volumin e madh të lëndëve për kontrollë. Për të dy Sektorët e Kontrollit në Drejtori kjo tashmë është një praktikë rutinë, përcjellja deri në detaje e të dhënave nga terreni deri në Qendër e më tutje. Në bazë të këtyre Raportimeve të përditshme njihet situata dhe merren vendimet e duhura për përballimin e një numri të madh kontrollesh dhe programit në tërësi.

Vështirësitë në Kontrollin e Pagesave Direkte

- ❖ Numri i madh i Lëndëve për Kontrollë dhe Normat e larta të kontrollit. Mos-harmonizimi i normave të kontrollit për masa të aplikuara, kur ato janë në një aplikacion për çdo fermer;
- ❖ Numri i kufizuar i Resurseve Njerëzore, (angazhimi i përkohshëm i zyrtarve, Stafi mbështetës i paplanifikuar mirë dhe i papërgatitur sa duhet etj);
- ❖ Mosdefinimi i kriterëve dhe specifikave në program, (bletaria, kungujt, mos kompletimi i programit);
- ❖ Digjitalizimet e gabuara dhe gabimet tjera në aplikim (nga fermerët aplikant apo zyrtarët komunal);
- ❖ Vonesa në shpalljen e thirrjes për aplikim dhe shtyrja e afateve të aplikimit, (që tashmë është bërë e zakonshme sidomos gjatë vitit 2021 ka qenë vones jashtë çdo kriteri);
- ❖ Problemet me fermer të pandërgjegjshëm që nuk i përgjigjen kontrollit, (shkaktojnë vonesa të shumta) dhe problem shumë i madh është kur fermeri e krijon pengimin i inspektorëve në kryerjen e detyrave-kontrollit në terren ;
- ❖ Vonesat në trajtimin Administrativ të lëndëve dhe gabimet gjatë kontrollit administrativ dhe lëshimet e sistemit elektronik të përzgjedhjes.

Misioni

Pjesa e përgjegjësive për implementimin e programeve mbështetëse për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke zbatuar procedurat e shkruara të cilat janë të bazuara në IPARD i takon Sektorit të Kontrollit të PZHR-së që vepron në kuadër të Drejtorisë së Kontrollit.

Në këtë zingjirë të përgjegjësive për implementimin e Masave të PZHR me mbështetje nga Programi Nacional, ky sektor është përgjegjës për zbatimin e procedurave të kontrollit në terren të aplikuesit para miratimit dhe të përfituesit e Projekteve të Zhvillimit Rural, pas kërkesës për pagesë.

Vizioni

Spektori i kontrollit ka për qëllim pasqyrimin real të gjendjes në terren për t'ju trasuar rrugën dy drejtorive të AZHB-së (Drejtorisë së Miratimit për miratimin e PZHR-së dhe Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave për t'i proceduar pagesat pas kontrollit të dytë në terren). Duke pasur këtë rol ky sektor vazhdon të mbetet një nga hallkat e rëndësishme së veçantë në zingjirin e implementimit të Programit Nacional për PZHR-në, duke ndikuar në zhvillimin e këtij Spektori të rëndësishëm të ekonomisë.

Bazuar në Programin për Zhvillim Rural 2020 -2021 U/A 02 / 2020 për Masat dhe Kriteret e përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2020 -2021. Udhëzuesin për aplikues si pjesë e udhëzimit administrativ për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2020-2021, mbi bazën e këtyre udhëzimeve janë kryer kontrollat e para në terren për PZHR-në 2020-2021, dhe numri i konsiderueshëm i kontrollave të dyta për PZHR-në 2019.

Në kuadër të Drejtorisë së Kontrollit sikurse viteve tjera edhe këtë vit Spektori i Kontrollit të PZHR-së ka kryer funksionet dhe aktivitetet e veta sipas Planit Vjetor të Punës për Zhvillimin e Bujqësisë, Programin mbështetës vjetor të MBPZHR-së për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Rregullores së Brendshme të Kontrollit si dhe Bazuar në U/A të lartëcekur për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2020 -2021 (të gjitha të bazuara në Planin Strategjik për Zhvillimin e Bujqësisë 2014-2020).

Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për PZHR-në (në bazë të të cilit janë kryer kontrollat e para në terren për PZHR-në 2020-2021), aktivitetet e zhvilluara vjetore të PZHR-së për vitin 2020-2021 janë kryer numër i madhë i kontrollave vjetore për një periudhë mjaft të kufizuar kohore (kur kemi parasysh vonesat në dikasterët tjerë për përgatitjen e programit të masave për vitin 2020-202, nga MBPZHR si dhe vonesat nga Drejtoria e Miratimit), kontrolli i projekteve dihet që ka qenë në disproporcion të resurseve humane, teknike dhe teknologjike, por megjithatë kontrolli në terren ka arritur të përmbyllë dhe finalizojë raportet e të gjeturave në terren në kohën e paraparë .

Vështërsi tjera me të cilat duhet të mësohemi e të pajtohemi janë procedurat e shumta të cilat i zbatojmë ne, (sipas standardeve IPARD), është një punë shumë e vështirë dhe e ngarkuar. Programi i miratuar me vonesë, pa detajet e duhura teknike të nënmasave të ndryshme është kryer me maksimum 13 ekipe kontrolli. Paraprakisht janë hartuar dokumentet përkatëse me të cilat janë njoftuar inspektorët.

Programi i Granteve që ka mjaft detaje të padefinuara mbetet për t'u përfunduar gjithmonë në fund të vitit pasi që vonesat dhe shtyrjet e aplikimeve reflektojnë gjithmonë në përfundimin e punimeve në fund të vitit që e stërngarkon edhe Sektorin e Kontrollit të Granteve jashtë norme, pasi që inspektorët e njëjtë duhet të kryejnë aktivitetet edhe në Pagesa Direkte edhe në PZHR në të njëjtën periudhë kohore, në gjashtë mujorin e dytë të vitit dhe si rrjedhojë e gjithë kësaj vihet në rrezik edhe kualiteti i kontrollit duke punuar me nxitim për të zënë ekzekutimin e kontrollit deri në përfundim të vitit fiskal.

Poashtu edhe inspektorët e kontrollit në terren prej 13 ekipeve nuk janë të strukturuar sa dhe si duhet, kur kihet parasysh se shumë nga inspektorët nuk janë të drejtëve adekuate për të kryer kontrollin e ndërtimeve dhe kontrollin e pajisjeve për teknologji të reja të cilat i kontrollojnë në terren. Vështirësitë Administrativo Juridike teknike dhe logjistike kanë qenë një punë kolosale që janë arritur me një përballje dhe me një përkushtim të jashtëzakonshëm nga stafi menaxhues dhe inspektorët në terren, këtu duhet cekur vonesat në

regjistrimin e automjeteve zyrtare si pasojë e procedurave të tenderimit dhe vonesave që na ka shkaktuar pandemia, si dhe zhvillimet e krijuara nga rasti subvencionit nga krimet ekonomike.

Të gjitha lëndët e pranuar nga Drejtoria e Autorizimit të pagesave për kontrollin e dyta PZHR 2019, 2020-2021, para pagesës janë përfunduar në afat optimal, para mbylljes së buxhetit. Në vitin pasues kanë mbetur për vazhdim të Programit të Kontrollit, sipas kontratave që kanë lidhur përfituesit e PZHR-së me AZHB-në të cilët janë të obliguar t'i implementojnë projektet e tyre brenda afateve të përcaktuara me kontratë.

- ❖ **Udhëzuesi për Inspektor** - Janë përgatitur udhëzuesit për inspektor dhe janë përcjellur në formë elektronike. Këta udhëzues së bashku me standardet nacionale të kontrollit ju kanë ndihmuar ekipeve të terrenit për kryerjen e inspektimeve për masa dhe nënmasa siaps U/A në fuqi.
- ❖ **Konsultat e vazhdueshme** me Drejtorinë e Drejtorisë së Kontrollit dhe bashkëpunimi me drejtoritë tjera në AZHB si dhe këshillat e zhvilluara me secilin inspektor që kanë kryer inspektime të PZHR-së, kanë patur për qëllim të minimizojnë rrezikun dhe shmangien e konfliktit të interesit duke e rritur cilësinë e inspektimeve dhe duke e menaxhuar sa më mirë kohën dhe kjo ka ndikuar njëkohësisht edhe në uljen e devijimeve të cilësisë së kontrollit dhe shpenzimeve.
- ❖ **Punët Logjistike** - Kanë qenë një pengesë tjetër, pasi që problemet me servisimin dhe regjistrimin e veturave zyrtare për një periudhë relative kohore i kanë penguar kryerjen e kontrollit në terren. Ka pasur raste që inspektorët kanë qenë të angazhuar edhe ditëve të vikendeve sipas vendimit nga Kryeshefi i AZHB-së, por mos regjistrimi i automjeteve me kohë nga Zyra e Logjistikës ka bërë që shpesh dhe disa prej tyre edhe të denohen edhe me gjopa të mëdha. Te stafi Logjistik i AZHB-së, janë përcjellur vetëm shkresat, raportet e automjeteve dhe kërkesat për servisim, kurse punët teknike dhe praktike janë kryer nga vetë Inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit.
- ❖ **Raportimi** – janë vazhduar dhe kthyer në traditë raportimet ditore, qarkullimi i madh i lëndëve dhe kërkesat e mëdha për kontrollë bëjnë që të jemi jashtëzakonisht të angazhuar në përcjelljen e situatës në vazhdimësi . Çdo herë dhe në çdo kohë monitorimi është i vazhdueshëm, përcjellja e numrit të kontrolleve, ekipeve ,automjeteve, shpesh duke ndërhyrë në proces si në kompletimin e ekipeve të kontrollit aty ku janë paraqitur nevojat për raste të caktuara.
- ❖ **Ex-Post Kontrolli** – Janë pranuar 551 lëndë nga Drejtoria e Autorizimit për Ex-post kontrollë, ndërsa janë kryer gjithësej 551, kontrollat PZHR 2018. Nga ky monitorim është pasqyruar gjendja në terren për fermerët përfitues ku janë verifikuar aktivitetet e biznesit për projektet e realizuara, vazhdimësia e projektit, posedimi i pajisjeve të përfituara, kontributet e punëtorëve etj.
- ❖ Me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB-së është punuar në kontrollat e kërkuara nga Policia e Krimeve Ekonomike në lëndet e përzgjedhura në Pagesa Direkte dhe PZHR.

Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit

Spektori i Kontrollit të Projekteve për Zhvillim Rural si gjithnjë ka qenë i varur nga kërkesat për kontrollë në terren të dy Drejtorive të Projekteve të Zhvillimit Rural (nga Drejtoria e Miratimit për PZHR – 2020-2021 të Projekteve dhe Drejtoria e Autorizimit të Pagesave për PZHR – 2019 dhe për vitin 2020-2021).

Realizimit të këtyre aktiviteteve i ka parapri realizimi i procedurave të domosdoshme Administrative. Hartimi i Planeve të Punës, vlerësimi dhe miratimi i tyre, rishikimi dhe riplanifikimi i resurseve njerëzore, tekniko-profesionale dhe logjistike. Në fillim të vitit është punuar me Udhëzuesit për punën e inspektoratit

në terren si dhe për korigjimin dhe adaptimin e raporteve sipas nënmasave të reja për të parapërgatitur inspektoratin e terrenit për realizimin e programit të vitit 2020-2021 për PZHR-në dhe vazhdimin e PZHR-së 2019 të bartura në vitin 2021(kontrollat e dyta para pagesës).

Vlenë të ceket se puna për hartimin e Formës dhe Përmbajtjes së Raporteve të Kontrollit në terren për Projektet e Zhvillimit Rural që është mjaft e rëndësishme, pasi që çdo vit ballafaqohemi me nënmasa të reja dhe për këtë Sektorin e Kontrollit të PZHR-së i ka harmonizuar dokumentet e kontrollit sipas masave dhe nënmasave në mënyrë që të jenë sa më të qarta, më përmbajtësore dhe të përfshijnë në vete sa më shumë të dhëna mbi të gjeturat e kontrollit në terren.

Trajnimet dhe takimet

Me qëllim të menaxhimit të kohës, rritjes së efikasitetit në punë dhe kryerjes së inspektimeve në mënyrën më të mirë të mundshme, janë shfrytëzuar takimet me rastin e pranimit dorëzimit të lëndëve për kontrollin në terren dhe janë këshilluar inspektorët për qasjen gjatë inspektimit dhe sfidat me të cilat duhet të përballen me rastin e kontrollit në terren. Lidhur me rregullat e kontrollit, përdorimin e mjeteve për kontrollë, risit e Programit për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale për vitin 2020-2021.

Si e përsëritur nga viti i kaluar e cila ka dhënë rezultatet e veta ka qenë futja në përdorim e sistemit të digjitalizimit të Parcelave në kontrollin e parë (para miratimit), ku janë planifikuar ti kryejnë investimet e tyre fermerët edhe pse nuk ka qenë e domosdoshme sipas U/A në fuqi por kjo ka rritur sigurinë e kontrollit.

Vazhdimi i Kontrollit në terren i Projekteve të vitit 2019 të bartura në vitin 2020-2021

Kanë vazhduar kontrollat për masat e projekteve për Zhvillim Rural-Projektet vitit 2019, të bartura në vitin 2021, sipas kontratave të lidhura në mes të përfituesëve të PZHR-së me AZHB-në.

Tabela-1: Kontrollat e rregullta për PZHR 2019 në vitin 2021 janë përfunduar 20 kontrollat të dyta. Kontrollat të rregullta për PZHR-2020/2021 para miratimit janë përfunduar 418 kontrollat të rregullta dhe 9 rikontrollat.

Kontrollat të rregullta për PZHR 2020/2021 para pagesës janë përfunduar 313 kontrollat dhe 18 rikontrollat. Në bazë të kontrollave të para shifet se kanë mbetur për kontrollë të dytë një numër i madh i lëndëve (105 lëndë). Ku nuk e dimë a janë tërhequr a kanë ende afat për dorëzim të kërkesës për pagesë.

Lëndet e pranuar	Të Pran. nga DMPZHR	Të Kth. në DMPZHR	MBETJA	Të Pran. nga DAP	Të Kth. në DAP	MBETJA
101.1a- Pemë drufrutore- 2019				2	2	0
101.6- Sektori i vezëve- 2019				2	2	0
302.5- Akuakultura- 2019				1	1	0
303- GLV- 2019				10	10	0
Masa për ujtitjen e tokave- 2019				1	1	0
103.1- Përpunim i qumshtit - 2019				1	1	0


103.2- Përpunim i mishit - 2019				1	1	0
103.3- Përpunim i pemëve dhe perimeve- 2019				2	2	0
Totali i pranimit të lëndëve të pranuar të vitit 2019 për kontrollën 2021				20	20	0
	PZHR- 2020-2021					
101.1a-Pemë drufutore	86	86	0	65	65	21
101.1.1- Pemë arrorre	35	35	0	25	25	10
101.2- Serra	124	124	0	108	108	16
Totali i masës 101	245	245	0	198	198	47
302.1.1- Prodhimi , promovimi i mjaltit	63	63	0	51	51	12
302.2- Përp. i Prodh. Bujq. në Eko. Fam.	26	26	0	17	17	9
302.3-Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	19	19	0	11	11	8
302.6- Rritja e shpezeve për vezë e mish	40	40	0	28	28	12
Totali I masës 302	148	148	0	107	107	41
Ujitja e tokave bujqesore	1	1	0	1	1	0
Totali i ujitjes së tokave	1	1	0	1	1	0
103.1- Përpunim i qumështit	3	3	0	1	1	2
103.2- Përpunim i mishit	4	4	0	4	4	0
103.1- Përpunim i pemëve dhe perimeve	13	13	0	1	1	12
103.4 – Prodhim i verës	4	4	0	1	1	3
Totali I masës 103	24	24	0	7	7	17
Totali i të gjitha masave 2020-2021	418	418	0	313	313	105
Totali i të gjitha masave 2019				20	20	0
Rikontrollat -2020-2021	9	9	0	18	18	0
TOTALI- Masat 2019-2020/2021	418	418	0	333	333	105
Subtotali – Masat - Rikontrollat	427	427	0	351	351	105

Tabela 70 Numri i gjithmbarshëm i kontrolleve të realizuara në terren për projektet e Zhvillimit Rural gjatë vitit 2021 , sipas masave të miratuara

1	Kontrolli i dytë (pas investimeve dhe para pagesës) i granteve - 2019	20
2	Kontrolli i parë i PZHR-së2020-2021 (para miratimit)	418

3	Kontrolli i dytë (pas investimeve dhe para pagesës) i granteve - 2020/2021	313
4	Rikontrollet	27
5	Ex-post kontrollat- 2018	551
Gjithsej		1329

Tabela 71 Totali i kontrolleve të rregullta për PZHR – 2019 të realizuara në vitin 2021 dhe 2020- 2021



Grafikoni 32 Parqitja me grafikon e kontrolleve të PZHR-së 2020/2021

Kontrolli i Projekteve për masat mbështetëse të Zhvillimit Rural 2020/2021

Kontrolli në terren për Masat e Zhvillimit Rural është një proces i cili varet nga:


- ❖ Kriteret e miratuara nga Autoriteti Menaxhues;
- ❖ Detajet teknike të Realizimit të Projekteve;
- ❖ Koha e thirrjes për aplikim;
- ❖ Koha e kontrollit administrativ dhe verësimit;
- ❖ Koha e përgatitjes së listave, ngarkimi i lëndëve të inspektorët për kontrollë (kontrolli i parë dhe kontrolli i dytë);
- ❖ Vlerësimi i raporteve të kontrollit të hartuara nga inspektorët dhe kthimi i lëndës të drejtoritë përkatëse.

Bazuar në miratimin e Programit për Buqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019 dhe 2020/2021, Divizioni i Kontrollit u mobilizua fillimisht në përpunimin e këtij programi në mënyrë që të shihen ndryshimet dhe risitë në masat dhe sektorët nga viti paraprak.

Gjatë vitit 2021 janë përfunduar këto kontrolla të mbetura nga viti 2019 e të cilat kontrolla janë përfunduar në vitin 2021.

Masa 101	3
Masa 103	4
Ujitja	1
GLV-të	10
Masa 302	2
Totali	20

Tabela 72 Kontrolla e dytë (para pagesës për PZHR- 2019 të kryera në vitin 2021)



Kontrolli para miratimit për PZHR-në 2020/2021 janë kryer gjithësej 418 kontrolla me këto masa:

Për masën 101 ku janë përfshirë 3 nënmasa kanë qenë gjithësej 245 lëndë dhe një pjesë e nënmasave sidomos ato për blegtorinë nga masa 101 nuk është shpallur aplikimi.


Për masën 302 ku janë pëfshirë 4 nënmasa janë kryer 148 lëndë.

Masa 103 – ku janë të përfshira 4 nënmasa me 24 lëndë.

Ujitja e tokave bujësore është vetëm 1 lëndë.

Masa 101	245
Masa 103	24
Ujitja	1
Masa 302	148
Totali	418

Tabela 73 Kontrollat e para (para pagesës për PZHR- 2020-2021)



Kontrolla nga PZHR 2020/2021 kanë qenë gjithësej 313 kontrolla, sipas masave e nënmasave në vijim të cilat u panë edhe në tabelën më lart:

Masa 101: me 3 nënmasat janë kryer gjithësej 198 kontrolla.

Masa 103 :me 4 nënmasat së përpunimit të qumështit janë kryer 7 kontrolla.


Masa 302 :me 4 nënmasat kanë qenë gjithësej 107 kontrolla.

Për masën Ujitja e tokave bujqësore janë kryer 1 kontrolla.

Masa 101	198
Masa 103	7
Masa 302	107
Ujitja	1
Totali	313

Tabela 74 Kontrollat e dytë (para pagesës për PZHR- 2020/2021)

Grantet- Kontrollat e dyta 2020/2021



Grafikoni 33 Kontrollat e dytë (para pagesës për PZHR 2020/2021) sipas Grafikut



Figura 4. Disa fotografi gjatë kontrollit të PZHR-së gjatë kontrollave të dyta të realizuara në terren.

Vështirësitë gjatë kontrollit në terren për Projektet e Zhvillimit Rural

Këtu duhet vënë në pah edhe gabimet teknike gjatë vlerësimit të tyre, si: mos përcaktimi i moshës së fidaneve, numri i shtyllave të rrethojës, mos përshkrimi i drejtë i numrave serik, mungesat në dokumentacion (që ka raste kur ndodh të mos dorozohet dokumentacioni komplet që nga zyrtarët rajonal e deri tek zyrtarët e vlerësimit apo autorizimit të pagesave). **Mangësitë e përpilimit dhe detajizimit të kriterëve si dhe precizimi i detajeve teknike** shpesh reflektohen gjatë kontrollit në teren dhe në procesin e hartimit të raporteve nga kontrolli në terren i cili bie ndesh me projektin e miratuar.

- ❖ Inspektorët gjatë kontrollit në terren shpesh është dashur të improvizojmë (matja e trashësisë së gypave, rezervuarëve të ujit ,trashesit e pllakave bazë të betonit, si dhe materiale tjera zonat e pa dukshme) dhe kjo paraqet një vështërsi në procesin e kontrollit.

- ❖ Kërcnimet ndaj inspektorëve dhe presionet e ndryshme gjatë kontrollit në terren edhe pse janë zvogluar mund të thuhet se ende nuk është arritur një vetëëdijsim i mjaftueshëm i popullatës për rrespektimin e ligjit dhe të organit shtetror.

- ❖ Masat dhe nënmasat e reja në Programin për Bujqësi 2020/21, njëkohësisht e kanë shtuar edhe llojllojshmërinë e inspektimeve në terren. Inspektorët e angazhuar në kontrollin e PZHR-së janë në numër mjaft të kufizuar dhe sipas rregullit duhet të ndrohen inspektorët e kontrollit të parë (para miratimit) dhe inspektorët e kontrollit të dytë(para pagesës).

- ❖ Shumë ankesa për vlerësimet nga miratimi që nuk kanë të bëjnë direkt me Drejtorinë tonë por indirekt ndikojnë në proces të punës duke na marrë kohë me pjesëmarrjen tonë në komisione për shqyrtimin e atyre lëndëve.

- ❖ Poashtu në pamundësi të kompenzimit të rrezikshmërisë ende kemi paknaqësi te stafi i kontrollit dhe kjo mund të ulë motivin për punë efikase.

- ❖ Mbështetja jo e knaqshme për materiale shpenzuese në zyrë, si tonera për kompletimin e raporteve të kontrollit (teknologjia e vjetruar pa mjaftueshmëri të ngjyrës së tonerit, ndodh që të del ndonjë foto nga printeri jo shumë e qartë për ndonjë objekt të fotografuar), vonesat në servisim të veturave, vonesat në regjistrimit e tyre dhe cilësia e ulët e servisimit të automjeteve, etj.), janë dobësi të cilat ndikojnë në motivin e punës së inspektoratit.

- ❖ Vonesat në aplikim, të gjitha këto janë dobësi të cilat vitin në vazhdim presim të përmirësohen dhe të kthehen në avantazhe.

- ❖ Siq e dijmë të gjithë pandemia, ka shkaktuar probleme duke prekur jo vetëm përfituesit e PZHR-së por edhe stafin esencial të Drejtorisë së Kontrollit dhe kjo ka bërë që një numër i vogël i kontrollave të kryhen pas përfundimit të pandemisë.

Tabela : Totali i kontrolleve të realizuara gjatë vitit 2021

Tabela : Totali i kontrolleve të realizuara gjatë vitit 2021		
1	<i>Kontrolli i dytë (pas investimeve dhe para pagesës) i Granteve 2019</i>	20
2	<i>Kontrolli i parë i PZHR-2020 / 2021 (para Miratimit)</i>	418
3	<i>Kontrolli i dytë (pas investimeve dhe para pagesës) i Granteve 2020/2021</i>	313
4	<i>Rikontrollet</i>	27
5	<i>Ex-Post Kontrollet - Përfituesit / 2018</i>	551
6	<i>Pagesa Direkte</i>	5373

Tabela 75 Numri i përgjithshëm i kontrolleve në terren i realizuar gjatë vitit 2021

Të arriturat

- ❖ Bazuar në të gjitha rrethanat, kontrolli është realizuar me efektivitet dhe efikasitet të lartë teknik-profesional dhe moral, prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit;
- ❖ Përkundër vështërsive dhe mungesave në këtë vit kemi ngritje cilësore në procesin e kontrollit dhe hartimit të raporteve, pasiqë raportet nga terreni janë shumë më konkrete dhe më të kompletuara me të dhëna për investimet e realizuara nga përfituesit e granteve dhe gjendjen në terren, këtë e ka dëshmuar edhe numri më i vogël i lëndëve të kthyer nga drejtoritë përkatëse për plotësim të raporteve të kontrollit nga terreni;
- ❖ Sipas rekomandimit (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbaj raportit dhe evitimi i dobësive tjera, me një angazhimi maksimal është rritur përmirësim në raportet e kontrollit;
- ❖ Është përmisuar në një masë edhe qasja e inektorëve për kontrollë, me ç'rast gjatë vitit 2021 kemi pasur më pak raste të ankesave nga Aplikantët;
- ❖ Nga Sektori i Kontrollit tek drejtoritë përkatëse lëndët janë proceduar brenda afateve ligjore dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështërsi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë;
- ❖ Edhe sistemi elektronik i pranim - dorëzimit të lëndëve ka funksionuar mirë këtë vit në krahasim me vitin e kaluar;
- ❖ Në masë të madhe është vërejtur ulje e shkallës për tentim të mashtrimit nga përfituesit e projekteve.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

1. Efikasiteti i veprimit të kontrollit në terren dhe cilësia mund të themi se janë brenda kriterëve të MBPZHR-AZHB-së, kjo është vërtetuar nga raportet e hartuara nga inspektorati. Këto raporte kanë qenë reale dhe brenda kriterëve të parapara për kontrollin në terren edhe pas ex-post kontrolleve, kur kihet parasysh se kontrollat janë bërë në një vit të vështirë në të gjitha aspektet (dhe me numër të vogël të ekipeve , gjithsej 10), nomra e kontrollit për ekip 433 mesatare për ekip.
2. Përmirësimi i kushteve të punës dhe ambienteve të zyrave si dhe pajisja me mjete të nevojshme për punë në vitin vijues, duhet të jetë prioritet tjetër i AZHB-së.
3. Profilizimi jo i mjaftueshëm i inspektorëve për kontrollin e masave të caktuara të PZHR-së, mendojë se është edhe një prej dobësive të cilat në të ardhmën duhet të përmisohen, nëse shtohet numri i Inspektorëve/Kontrollorëve të terrenit dhe nuk përdoret i tërë kontigjenti i kontrollit për të gjitha llojet e kontrollit.

4. Reforma në numër të inspektorëve dhe profilizimit të tyre për projekte të caktuara do të rritë performacën e inspektorëve dhe krahas kësaj do të rritet edhe cilësia, efikasiteti dhe do të zvoglohet rreziku dhe koha e kryejës së lëndëve të PZHR-së.
5. Duhet të bëhet pagesa e rrezikshmërisë, si masë motivuese për përmirsimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës në Sektorin e Kontrollit të PZHR-së, bazuar në rreziqet, presionet dhe kërcnimet nga fermerët, gjithashtu edhe rreziku që vjen si rezultat i sëmundjeve të ndryshme transmissive (zoonozat), ndaj të cilave inspektorët ekspozohen direkt gjatë kontrollit të kafshëve, shpezëve, rreziku nga pickimi i rriqrave, nga gjarprinjtë etj.
6. Gjatë kontrollit në terren kemi pasur si çdo vit pengim në punën e inspektorëve, prandaj duhet të inicohet procedurë nga sektori ligjor i AZHB-së ndaj këtyre rasteve me ndonjë memorandum bashkëpunimi me MPB-në. Të rritet vigjilenca e policisë në mbrojtjen ligjore të inspektorëve gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe në këtë kontest të ketë vëmendje më të madhe nga zyra ligjore e AZHB-së, dhe të pëcillet se deri ku po arrijnë procedurat tek organet përgjegjëse, për rastet e kërcënimeve të inicuar nga vet inspektorët e AZHB-së .
7. Efikasiteti dhe cilësia e veprimit të kontrollit në terren mund të themi se janë brenda kriterëve kualitative, kjo arsyetohet me faktin ku vërtetohet se raportet e hartuara nga inspektorati kanë qenë reale dhe brenda kriterëve të parapara për kontrollin në terren. Ka raste që për shkak të volumit të madh të inspektimeve dhe lodhjes sidomos pas dite që ju përvjedhet ndonjë gabim pa dëshirën e tyre dhe tërë kjo qëndron brenda suazave të punës.
8. Rritja në cilësinë e performacës edhe më tutje ka vend në punën e inspektoratit dhe të gjithë neve.
9. Kushtet e punës dhe ambienteve të zyrave si dhe paisja me mjete të nevojshme të inventarit, automjeteve si dhe IT është jo e përmirësuar në vitin 2021.
10. Të planifikohet ulja e përqindjes (zvoglimi i mostrës) së kontrollit të masave të Pagesat Direkte, meqë normat e larta të kontrollit për Pagesa Direkte dhe vonesat në përgatitjen e Programit në tërësi ç' rregullojnë tërë ritmin e punës në AZHB e sidomos tani që jemi me një stafë të përgjysmuar.
11. **Pagesa e Rrezikshmërisë për Drejtorinë e Kontrollit-** (duke pasur parasysh se sipas normave ligjore u takon edhe ish Inspektorëve të MBPZHR-së, që kanë kaluar në Inspektor Terreni/Teknik kanë marrë rrezikshmërinë), si masë motivuese në përmirsimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës, bazuar në rreziqet, presionet dhe kërcnimet nga fermerët gjithashtu edhe nga bartja e sëmundjeve të ndryshme transmissive të inspektorët gjatë kontrolli i kafshëve, shpezëve dhe pickimi i rriqrave.
12. Inicimi i procedurave për **Mbrojtjen me Ligj të Inspektoratit** para kërcënimeve dhe kërcënuesve, gjatë kontrollit në terren, përkatësisht nga sektori ligjor i AZHB-së dhe MBPZHR-së të ketë vëmendje më të madhe se deri ku po arrijnë procedurat e inicuar nga vet inspektorët në momentin e kërcënimit tek organet përgjegjëse etj.

PËRFUNDIM

Marrë në tërësi Drejtoria (departamenti) e Kontrollit, duke u bazuar në rrethanat aktuale të standardeve-kritereve programore, juridike, resurseve në dispozicion si dhe kushtet e zbatimit të kritereve IPA në rrethanat e Bujqësisë Kosovare, ka arritur që në nivel të duhur të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e parashtruara të kontrollë-verifikimit dhe raportimit të përmbylljes së projekteve në terren, pagesave direkte dhe kontrolleve tjera, bazuar në planin vjetor të punës, planet sektoriale, bazën programore dhe juridike të kërkesave, lëndët nga sektori i kontrollit tek drejtorit përkatëse janë proceduar brenda afateve ligjore dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështërsi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë.

Bazuar në të gjitha rrethanat, administrative, kushtet teknike, bazën ligjore-juridike, programore dhe parametrat tjerë të angazhimit dhe operimit mund të themi se kontrolli në terren është realizuar me efektivitet të kënaqshëm teknik dhe profesional, prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit.

Angazhimi maksimal në plotësimin e rekomandimeve (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbajë (raporti dhe evitimi i dobësive tjera).

Presim që në vitin në vijim të rritet numri i resurseve humane, kushteve të punës dhe mjeteve themelore të punës e përmirësimin e situatës së përgjithshme që të rritet angazhimi dhe performanca e operimit në terren.

DREJTORIA PËR KOORDINIM ME ZYRET REGJIONALE

DKZR-ja është e angazhuar t'i kontribuoj AZHB-së në përmbushjen e misionit dhe vizionit të saj për zhvillimin bujqësisë përmes implementimit të programeve mbështetëse të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

DKZR-ja gjatë vitit 2021 përveç përmbushjes së detyrave të përcaktuara si departament është angazhuar edhe në përkrahjen e departamenteve tjera sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura në vazhden e aktiviteteve të ndryshme, kjo edhe si rezultat i mungesës së theksuar të stafit në përgjithësi në AZHB.

Në këtë kuptim, veçanërisht DKZR-ja ka qenë krejtësisht e pa funksionalizuar deri në këtë vit, konkretisht në mesin e janarit është emëruar nga MAP-i Drejtori i Departamentit ndërsa nga marsi kemi të angazhuar një numër të kufizuar të zyrtareve përmes projektit të BB-së në kuadër të Zyrave Regjionale (ZR) deri me 31 dhjetor 2021. DKZR-ja në rast se nuk do të ju vazhdohet kontrata këtyre zyrtareve ose absorbimi/transferimi në staf civil atëherë në ZR nuk do të kemi zyrtar regjionale për pranimin e dokumenteve/pakos për pagesë. Prandaj kjo mbetet njëra nga sfidat kyqe edhe për vitin në vijim.

Vlenë të theksohet me këtë rast se përkundër numrit të kufizuar të këtyre zyrtarëve të angazhuar përmes BB-së, po ashtu në përballje edhe me mungesën e përvojës në këtë sektor, kanë arritur që të përballojnë volumin e kërkesave dhe një pjesë e tyre i janë përgjigjur pozitivisht edhe kërkesës së menaxhmentit dhe Drejtorisë së Kontrollit për përkrahje në kontrollat e terrenit për PPD 2021.

Duhet theksuar se në fillim të vitit, nga janar – mars në disa ZR edhe deri në qershor, kërkesat për avance dhe kërkesat për pagesë janë pranuar nga zyrtaret e Drejtorisë së Kontrollit të caktuar me vendim të zv. Kryeshefit, për shkak të mungesës së zyrtarëve të pranimit deri në angazhimin e zyrtarëve përmes BB-së.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (IT)

Hyrje

Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë si:

- Regjistri elektronik i fermerëve (eFR);
- Sistemi i thjeshtësuar i identifikimit të parcelave të tokës (sLPIS);
- sLPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në terren për sipërfaqe;
- Regjistri për menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin këto module:
 - ✓ Moduli për aplikimit në zyret komunale dhe
 - ✓ Modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB
- Ueb aplikacioni për aplikim për grante;
- Regjistri për menaxhimin e granteve i cili përfshinë këto module:
 - ✓ Modulin për kërkesën për pagesë të granteve,
 - ✓ Modulin për menaxhimin e granteve,
 - ✓ Modulin për autorizimin e pagesave të granteve,

✓ Moduli i kontrollit në terren për projekte të zhvillimit rural,

➤ Ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe 7 (shtatë) Zyret Regjionale. Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë menaxhimin e të gjithë shfrytëzuesëve (usereve) të domenit shtetrorë të zyrtareve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për krijimin e llogarive zyrtare dhe vazhdimin e tyre për qasjen në domenin shtetror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë janë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Drejtoria e Teknologjisë Informative bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Regjistrin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, ueb aplikacioni për aplikimit për grante, moduli për plotësimin e kërkesës për pagesë në zyrët regjionale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe moduli i kontrollit në terren) gjithashtu edhe ruajtja (backup) i të dhënave të serverit ku është instaluar Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR), ruajtja (backup) i të dhënave të Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte si dhe ruajtja (backup) i të dhënave të Sistemit të Thjeshtësuar për Identifikimin e Parcelave të Tokës (sLPIS).

Drejtoria e Teknologjisë Informative gjatë vitit 2021 ka bërë përgaditjen e kampanjës për aplikim për vitin 2021 për Projekte të Zhvillimit Rural sipas masave dhe nënmasave të caktuara në Udhëzimin Administrativ për Projekte të Zhvillimit Rural si dhe përgaditjen e regjistrit për vlersimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve. Pas përgaditjes së regjistrit për aplikim është dhënë mbështetje gjatë gjithë kohës së regjistrimit të aplikacioneve. Për Pagesa Direkte gjatë vitit 2021 është bërë përgaditja për aplikim përmes Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshinë dy module: moduli për aplikimit në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB ku është bërë përgaditja për aplikim për të gjitha llojet e subvencioneve për vitin 2021, si dhe është bërë përgaditja e Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku është bërë kopjimi komplet i të gjitha parcelave të vitit 2020 në vitin 2021 (për të lehtësuar aplikimin e fermerëve). Pas përgaditjes së kampanjës për aplikim për vitin 2021 janë mbështetur direkte zyrtareve komunal gjatë regjistrimit të aplikacioneve gjatë gjithë kohës së kampanjës për aplikim. Poashtu gjatë vitit 2021 është përgaditur kampanja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e parë TM1, dhe gjashtëmujorin e dytë TM2.

Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen dhe monitorimin e 2 blade enclosure, 7 blade server, 2 MSA storage, 2 External Ethernet Switches, 1 unitreds, 1 ultrium tape drive. Gjatë vitit 2021 në Regjistrin e Granteve përkatesisht në modulën për miratimin e granteve është përdorur forma e dërgimit të sms në mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për tu njoftuar

lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij gjithashtu e njejtë formë e dërgimit të sms-it dhe vendimit është përdorur edhe tek Regjistri i Pagesave Direkte.

Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë administrimin e të gjithë regjistrave që shfrytëzon AZHB-ja.

Në këtë skemë mund të shihet lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)




Figura 5. Skema e lidhjes së regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në këtë skemë mund të shihet Sistemi i Komunikimit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), databazat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) si dhe komunikimi i rrjetit të internetit në mes të

Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Ministrisë së Administratës Publike përkatësisht Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) gjatë vitit 2021:




Figura 6. Sistemi i komunikimit të AZHB-së, baza e të dhënave të AZHB-së si dhe komunikimi i rrjetit në mes AZHB-së me ASHI-së

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)


Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe / ose burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare. Regjistrimi i fermerëve është i rregulluar me "Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermereve" regjistrimi është vullnetar, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojnë për grante dhe subvencione. Gjatë vitit 2016 është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike ku gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerëve bëhet në zyrët komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyrët Regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Krijimi i përdoruesve dhe administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë Informative varësisht sipas pozitës së zyrtarit që duhet të ju krijohet përdorimi.

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) ka filluar të funksionoi në vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermer ndërsa në vitin 2013 kanë qenë të regjistruar 26,603 fermer, në vitin 2014 kanë qenë të regjistruar 34,775, në fund të vitit 2015 kanë qenë të regjistruar 43,166, në fund të vitit 2016 kanë qenë të regjistruar 50,164, në fund të vitit 2017 numri i fermerëve të regjistruar në eFR ka arritur në 55,448, në fund të vitit 2018 numri i fermerëve të regjistruar në eFR ka arritur në 61,017, në fund të vitit 2019 numri i fermerëve të regjistruar në eFR ka arritur në 66,224, në fund të vitit 2020 numri i fermereve të regjistruar në eFR ka arritur në 75,518, ndërsa në fund të vitit 2021 përkatësisht deri me datën 30.12.2021 numri i fermerëve të regjistruar ka arritur në 76,221 fermer në 37 komuna të Kosovës.

Gjatë vitit 2021 u është dhënë mbështetje direkte gjatë gjithë vitit zyrtarve komunal dhe zyrtarve regjional të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermereve (eFR).

Me poshtë në këtë diagram mund të shihni dallimet e numrit të fermerëve nëpër vite të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR):



Grafikoni 34 Numri i fermerëve në vite

Në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR) përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësor si dhe nënshkrimi i fermerit.

Për fermerin i kemi të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që merren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj.

Për tokën në shfrytëzim i kemi të dhënat për tokën e punueshme si ara, kopshte, lëndinë e përhershme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqën e tokës në pronë në hektar dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qëra, patate mbi 10 (dhjetë) hektar, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) hektar, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) hektar, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) hektar.

Për kafshë i kemi të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogj, bletë etj.

Për mekanizëm i kemi të dhënat për traktorë, motokultivatorë dhe autokombanja, dhe është pjesa e nënshkrimit ku në këtë pjesë përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit.

Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, "NIF" do të thotë Numri Identifikues i Fermës.

Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit ku në aneksin e eFR-së nënshkruhet zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri.

Regjistri Elektronik i Fermereve (eFR) është i lidhur me Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku nuk mund të kalohet në sLPIS pa qenë i regjistruar në eFR.

Në skemën e mëposhtme mund të shihet procesi i regjistrimit të fermerit në eFR:




Figure 7. Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR

Me poshtë mund të shihni Regjistrin Elektronik të Fermereve (eFR) i cili është ueb aplikacion dhe funksionon në tri gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Serbisht:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Regjistri elektronik i fermerëve

Home EFR Statistics History Administration

Kërko Fermeri Tokat në shfrytëzim Kafshët Makineria >Nenshkrimi

NIF: Nr. personal: Kërkim i detajuar

Fermer i ri Pastro fushat Kërko

Nr. total i fermerëve: 72518

	NIF	Nr. personal	Emri	Mbiemri	Emri i babës	Komuna	Vendbanimi/Fshati	Kompania
...
...
...
...
...
...
...
...
...
...

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 ... Rezultati kërkimit: 43337

Refresh Delete Add Edit Print Export

Figure 8. Regjistri Elektronik i Fermëreve

Në eFR është i nderlidhur sLPIS-i (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) dhe Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku pas regjistrimit në eFR të fermerit kalohet në mënyrë automatike në sLPIS për digjitalizim të parcelave të tokës, po ashtu në menyrë autoatike kalohet në Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku bëhet aplikimi për të gjitha llojet e pagesave direkte.

Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) përmes këtij sistemi gjatë vitit 2021 është bërë aplikimi për të gjitha kultura bujqësore që janë subvencionuar si psh: kultura lavertare grurë, farë gruri, misër, tërshëra, luledielli, elbi dhe thekra, për perime në fushë të hapur kulturat: lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan i zi, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungulleshë, kunguj misri, asparagu, brokoli, fasule monokulturë, kungulli, speci, marulla, perime në serra, majdanozi dhe rrepka dhe për kulturat pemëtare permanente si: molla, dardha, ftoi, mushmolla, kumbulla, kajsia, arra, lajthia, aronia, pjeshka, qershia, vishnje, dredhëza, manaferra, mjedërr dhe boronica si dhe vreshtat egzistuese. Gjatë vitit 2021 është bërë aplikimi për të gjitha bimët mjekësore dhe aromatike po ashtu gjatë vitit 2021 përmes këtij sistemi është bërë aplikimi për bujqësinë organike për të gjitha kulturat e lartçekura. Pas hapjes së kampanjës për vitin 2021 janë trajnuar zyrtarët komunal për digjitalizimin e parcelave dhe u është dhënë mbështetje direkte gjatë digjitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermerëve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) është i nderlidhur me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit ku jemi duke i shfrytëzuar të dhënat për zonat kadastrale, kadastrin e parcelave, lumenjët dhe hekurudhat.

Me poshtë mund të shihni se si duket lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit:




Figure 9. sLPIS dhe ndërlidhja me Agjencinë Kadastrale përmes Geoportalit

Në këtë skemë mund të shihet funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE




Figure 10. Funksonimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE

Aplikimi i fermerëve për mbeshtetje ka qenë në rritje të vazhdueshme nëpër vite. Më poshtë do ti paraqesim aplikimet e fermerëve nëpër vite.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2011) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,825 fermer dhe janë digjitalizuar 37,891 parcela me grurë me 43,008.02 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 2,341 fermer dhe janë digjitalizuar 5,989 parcela me misër me 5,983.72 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 32 fermer dhe janë digjitalizuar 87 parcela me luledielli me 769.79 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 është 43,967 ndërsa i hektarve 49,761.53 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2012) për mbeshtetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,728 fermer dhe janë digjitalizuar 49,106 parcela me grurë me 53,933.52 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 3,726 fermer dhe janë digjitalizuar 11,202 parcela me 10,233.85 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 31 fermer dhe janë digjitalizuar 73 parcela me 487.12 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 është 60,381 ndërsa i hektarve 64,654.49 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,781 fermer dhe janë digjitalizuar 50,168 parcela me 52,003.32 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 41 parcela me 439.11 hektar, për misër kanë aplikuar 6,084 fermer dhe janë digjitalizuar 16,726 parcela me 15,171.26 hektar, për luledielli kanë aplikuar 14 fermer dhe janë digjitalizuar 37 parcela me 653.69 hektar dhe me perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,950 fermer dhe janë digjitalizuar 5,770 parcela me 3,889.05 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 është 72,742 ndërsa i hektareve 72,156.43 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,993 fermer dhe janë digjitalizuar 46,905 parcela me 47,289.34 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 49 parcela me 417.89 hektar, për misër kanë aplikuar 8,336 fermer dhe janë digjitalizuar 24,123 parcela me 21,091.00 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 23 parcela me 304.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,738 fermer dhe janë digjitalizuar 8,959 parcela me 5,870.85 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 4,291 fermer dhe janë digjitalizuar 7,700 parcela me 4,567.97 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 është 87,759 ndërsa i hektareve 79,541.62 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,859 fermer dhe janë digjitalizuar 55,008 parcela me 52,722.66 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 26 fermer dhe janë digjitalizuar 72 parcela me 775.78 hektar, për misër kanë aplikuar 7,978 fermer dhe janë digjitalizuar 24,091 parcela me 20,044.2 hektar, luledielli kanë aplikuar 2 fermer dhe janë digjitalizuar 2 parcela me 9.88 hektar, për thekër kanë aplikuar 76 fermer dhe janë digjitalizuar 150 parcela me 245.08 hektar, për elb kanë aplikuar 156 fermer dhe janë digjitalizuar 329 parcela me 285.14 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,439 fermer dhe janë digjitalizuar 10,359 parcela me 7294.75 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 43 parcela me 111.9 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 5,795 fermer dhe janë digjitalizuar 9,284 parcela me 5,368.18 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 është 99,338 ndërsa i hektareve 86,857.57 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2017 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 9,709 fermer dhe janë digjitalizuar 44,669 parcela me 42,381.02 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë digjitalizuar 46 parcela me 513.14 hektar, për misër kanë aplikuar 8,598 fermer dhe janë digjitalizuar 28,120 parcela me 23,914.52 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 9 parcela me 56.33 hektar, për theker kanë aplikuar 78 fermer dhe janë digjitalizuar 153 parcela me 201.99 hektar, për elb kanë aplikuar 227 fermer dhe janë digjitalizuar 488 parcela me 423.57 hektar, perime në

fushë të hapur kanë aplikuar 5,712 fermer dhe janë digjitalizuar 11,310 parcela me 7,928.36 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 13 fermer dhe janë digjitalizuar 70 parcela me 149.07 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 7,181 fermer dhe janë digjitalizuar 11,604 parcela me 6,805.51 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2017 është 96,469 ndërsa i hektareve 82,373.51 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,674 fermer dhe janë digjitalizuar 50,844 parcela me 47,303.09 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë digjitalizuar 50 parcela me 464.34 hektar, për misër kanë aplikuar 8,416 fermer dhe janë digjitalizuar 28,036 parcela me 23,370.36 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë digjitalizuar 8 parcela me 7.91 hektar, për thekër kanë aplikuar 83 fermer dhe janë digjitalizuar 158 parcela me 240.81 hektar, për elb kanë aplikuar 315 fermer dhe janë digjitalizuar 694 parcela me 570.80 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 6,878 fermer dhe janë digjitalizuar 13,260 parcela me 9,080.23 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 37 fermer dhe janë digjitalizuar 156 parcela me 420.24 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 8,050 fermer dhe janë digjitalizuar 12,735 parcela me 7,833.94 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 është 105,941 ndërsa i hektareve 89,291.72 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2019 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,833 fermer dhe janë digjitalizuar 40,341 parcela me 38,193.92 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 15 fermer dhe janë digjitalizuar 58 parcela me 578.56 hektar, për misër kanë aplikuar 9,497 fermer dhe janë digjitalizuar 34,396 parcela me 28,959.33 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë digjitalizuar 8 parcela me 7.91 hektar, për thekër kanë aplikuar 70 fermer dhe janë digjitalizuar 147 parcela me 214.98 hektar, për elb kanë aplikuar 273 fermer dhe janë digjitalizuar 654 parcela me 523.65 hektar, për tërshërë kanë aplikuar 505 fermer dhe janë digjitalizuar 1087 parcela me 1051.15 hektar perime në fushë të hapur kanë aplikuar 7,460 fermer dhe janë digjitalizuar 14,059 parcela me 9,381.99 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 25 fermer dhe janë digjitalizuar 247 parcela me 814.56 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 7,273 fermer dhe janë digjitalizuar 11,776 parcela me 7,891.36 hektar.


Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2019 është 102,966 ndërsa i hektareve 87,618.5 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2020 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,012 fermer dhe janë digjitalizuar 54,237 parcela me 49,165.54 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 26 fermer dhe janë digjitalizuar 86 parcela me 893.44 hektar, për misër kanë aplikuar 9,979 fermer dhe janë digjitalizuar 35,703 parcela me 29,349.38 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë digjitalizuar 8 parcela me 41.28 hektar, për thekër kanë aplikuar 59 fermer dhe janë digjitalizuar 132 parcela me 205.65 hektar, për elb kanë aplikuar 242 fermer dhe janë digjitalizuar 659 parcela me 469.41 hektar, për tërshërë

kanë aplikuar 568 fermer dhe janë digjitalizuar 1361 parcela me 1438 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 8,145 fermer dhe janë digjitalizuar 15,358 parcela me 9,742.24 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 63 fermer dhe janë digjitalizuar 313 parcela me 1,284.81 hektar, bujqësi mjekësore aromatike kanë aplikuar 85 fermer dhe janë digjitalizuar 267 parcela me 887.70 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 7,420 fermer dhe janë digjitalizuar 12,051 parcela me 8,466.89 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2020 është 120,175 ndërsa i hektareve 101,944.3 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2021 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 6,826 fermer dhe janë digjitalizuar 32,101 parcela me 30,319.87 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 16 fermer dhe janë digjitalizuar 65 parcela me 635.53 hektar, për misër kanë aplikuar 7,499 fermer dhe janë digjitalizuar 24,637 parcela me 20,239.99 hektar, luledielli kanë aplikuar 6 fermer dhe janë digjitalizuar 7 parcela me 19.69 hektar, për thekër kanë aplikuar 180 fermer dhe janë digjitalizuar 436 parcela me 569.54 hektar, për elb kanë aplikuar 864 fermer dhe janë digjitalizuar 2,680 parcela me 2,219.37 hektar, për tërshërë kanë aplikuar 746 fermer dhe janë digjitalizuar 1,850 parcela me 1,772.27 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 6,708 fermer dhe janë digjitalizuar 12,503 parcela me 7,322 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 56 fermer dhe janë digjitalizuar 198 parcela me 517.54 hektar, bujqësi mjekësore aromatike kanë aplikuar 56 fermer dhe janë digjitalizuar 100 parcela me 69.07 hektar dhe kultura pemëtare permanente kanë aplikuar 6,793 fermer dhe janë digjitalizuar 11,172 parcela me 7,937.57 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2021 është 85,749 ndërsa i hektareve 71,622.44 ha.

Në këtë grafikun mund të shihet numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqën e digjitalizuar gjatë kampanjave për aplikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021:



Grafikoni 35 Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS, numri i parcelave dhe sipërfaqja e digjitalizuar nëpër vite
Më poshtë mund të shihni Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS):




Figure 11. Sistemi i Thjeshtësuar për Identifikim të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Për kontrollë në terren nga inspektorët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë përdoren sLPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline) ku ngarkohen të dhënat nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) në sLPIS-Mobile. Bartja e të dhënave bëhet vetëm me qasje të llaptopit në rrjet qeveritar dhe bëhet bartja e të dhënave, ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një

komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i sLPIS-Mobile në lloptop është bërë nga Drejtoria e Teknologjisë Informative po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në terren. **Më poshtë mund të shihni sLPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në terren:**




Figure 12. sLPIS-Mobile

Regjistri i Granteve

Regjistri i Granteve: Ky regjister përmban:

- ✓ Ueb Aplikacioni për aplikim për grante;
- ✓ Modulën e miratimit të granteve;
- ✓ Modulën e autorizimit të pagesave;
- ✓ Modulën e kontrollit në terren;
- ✓ Modulën për kërkesën për pagesë.

Ueb moduli për aplikim për grante: Ky ueb modul është aplikacioni i cili është publikuar në IP publike ku përmes këtij ueb aplikacioni bëhet aplikimi për të gjitha masat dhe nënmasat që mbështeten nga MBPZHR-AZHB-ja. Aplikimi është online ku fermeri duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermëreve (eFR) ku përmes NIF-it (Numri Identifikues i Fermerit) emailit dhe fjalikalimit të regjistruar në

Regjistrin Elektronik të Fermëreve eFR kyqet në aplikacion dhe pastaj bënë aplikimin për grante sipas masave dhe nënmasave që mbështeten nga MBPZHR-AZHB-ja. Në këtë ueb aplikacion të gjitha dokumentate e kërkuara bashkangjiten si dokumente, ku pas përfundimit të aplikimit fermeri në email pranon njoftohet që ka aplikuar.

Më poshtë mund të shihni ueb aplikacionin për aplikim për grante të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:



ARDP v1.3.1.1

N.I.F.

Email'i

Fjalëkalimi

Captcha

UNEWSS6 BotDetect CAPTCHA ASP.NET Form Validation

[Kyçu](#) [Harruar Fjalëkalimin?](#)

Figure 13. Forma e kyçjes në ueb modulën për aplikim online

Miratimi i granteve

Miratimi i granteve: Gjatë vitit 2021 Regjistri për Miratimin e Granteve është përgaditur për miratimin e granteve të vitit 2021 sipas Udhëzimit Administrativ 2020/21. Pas aplikimit në ueb aplikacionin për aplikim për grante, zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me udhëzimin administrativ të vitit përkatës, përmes këtij softueri gjenerohen letrat informuese, bëhet përgaditja e kontratës që nënshkruhet nga fermeri dhe AZHB-

ja, po ashtu përmes këtij softveri bëhet dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur më vendimin e marrë për aplikacionin e tij.

Më poshtë mund të shihni softuerin për miratimin e granteve që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 14. Softuerin për miratimin e granteve

Autorizimi i Pagesave

Autorizimi i Pagesave: Gjatë vitit 2021 ky modul është përgaditur për Autorizimit të Pagesave të vitit 2021 ku kërkesat për pagesë janë plotësuar në zyret regjionale të AZHB-së, kalkulimi dhe autorizimi i pagesave është bërë nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave, ku bëhet kalkulimi i fakturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në terren dhe përgaditja e listës për pagesë.

Më poshtë mund të shihni softuerin për autorizimin e pagesave që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 15. Softuerin për autorizimin e pagesave

Moduli i kontrollit në terren: Ky modul përdoret nga Drejtoria e Kontrollit në Terren, ku përmes këtij moduli nga Drejtori i Drejtorisë së kontrollit caktohen lëndët për kontroll në terren dhe përcaktohen për secilën lëndë nga dy (2) inspektor. Pas definimit të lëndëve, përmes modulit të inspektoreve, secili inspektor sheh lëndët që ju kanë caktuar për inspektim. Pas kontrollit në terren inspektorët qasen në këtë modul ku në sistem plotësojnë të gjeturat në terren dhe në mënyrë automatike raporti kalon tek shefi apo personi përgjegjës të Modullit të Kontrollit, ku dhe bëhet vlerësimi/pranimi i kontrollit. Përgjegjësit e Drejtorisë së Kontrollit, e bëjnë pranimin e lëndës dhe vlerësimin e raportit të kontrollit në terren, dhe pas këtij vlerësimi, lënda bartet në mënyrë automatike tek departamentet përkatëse. Nëse është kontrolli i I-rë, atëherë lënda bartet tek Miratimi i Projekteve ndërsa nëse lënda është e kontrollit të II-të, lënda bartet tek Autorizimi i Pagesave.

Moduli i kontrollit në terren

Më poshtë mund të shihni modulin e kontrollit në terren që shfrytëzohet nga inspektorët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 16. Moduli i kontrollit në terren

Moduli për kërkesën për pagesë

Moduli për kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrët regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB, ku kërkesa për pagesë bëhet sipas masave dhe nënmasave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Gjatë plotësimit të kërkesës për pagesë gjatë vitit 2021 janë regjistruar të gjitha fakturat që janë sjellur nga fermerët që kanë bërë kërkesë për pagesë, gjatë gjithë kohës zyrtarët e Autorizimit të Pagesave mund të shohin se sa fermer kanë bërë kërkesë për pagesë.

Më poshtë mund të shihni modulin për kërkesën për pagesë i cili funksionon në shtatë zyrat regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 17. Moduli për kërkesë për Pagesë

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Ky ueb aplikacion përfshinë dy module: moduli për aplikim në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Përmes këtij ueb-aplikacioni është bërë aplikimi për të gjitha pagesat direkte për sipërfaqe (grur, misër etj, kultura pemtore permanente) si dhe të gjitha aplikimet për krerë (lopë qumështore, dele, dhi, bletë etj.). Ky aplikacion është i nderlidhur edhe me sLPIS (Sistemi i Thjeshtëzuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) ku pas digjitalizimit të parcelave bëhet aplikimi përmes këtij ueb-aplikacioni. Me ueb-aplikacionin e pagesave direkte bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lëndëve për kontroll në terren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagesë si dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij, përmes këtij ueb-aplikacioni bëhet komplet menaxhimi i pagesave direkte. Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Teknologjisë Informative në këtë ueb-aplikacion ka bërë krijimin e shfrytëzuesëve (usereve), rikthimin në aplikim të aplikacioneve që kanë bërë gabime zyrtarët komunal gjatë aplikimit si dhe mirëmbajtjen e të dhënave.

Më poshtë mund të shihet Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

SQ | EN | SR + Add

Logout Subsidies

Direct Payment v5.6.7.3

Administration Name SubsidySubtypeId Category SubsidyGroupId SEARCH

Definitions

Unit measures

Subsidy types

Subsidy subtypes

Subsidy groups

Subsidy criteria groups

Subsidy sanction groups

Subsidies

Documents

Applications

Reports

Campaigns

Change my password

Name	SubsidySubtypeName	UnitMeasureName	PriceType	Category
Akuakulturë	Tjera	Copë	Fiks	Vjetor
Aronia	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Arra	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Asparagu	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bizele	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bletë	Bletë	Copë	Fiks	Vjetor
Boronica	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Brokoli	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Buallica	Gjedhë	Krerë	Fiks	Vjetor
Bujqësia organike	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Dele për mbarëshëm	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Dhi për mbarëshëm	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Domate	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Dosat për riprodhim	Derra	Krerë	Fiks	Vjetor
Dredhëza	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor

« 1 2 3 4 5 » 1 - 15 / 62

Figure 18. Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Më poshtë mund të shihni aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte për të gjitha subvencionet



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada - Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of
 Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencia za Razvoj Poloprivrede/The Agriculture Development Agency

FORMULAR PËR APLIKIM/ OBRAZAC ZA APLIKACIJU

Pagesat Direkte

NIF: 1050486

Nr:30/01266

Viti

1. Zgjidh llojin e entitetit/ Izaberi tip lica?

Person Fizik/Fizicko Lice

Person Juridik/Pravno Lice

1a. Të dhënat për Personin Fizik (Fermerin)/Podaci o Fizickom Licu (Farmeru)

Emri/ Ime	Test	Mbiemri/ Prezime	Test
Emri i babait/ Ime oca	Test	Data e lindjes/ Datum rodjenja	12/12/1980 12:00:00 AM
Numri Personal/ Licni broj	1231231239	Telefoni/ Telefon	044/000/000
Komuna/ Opština	Prishtinë/ Pristina	Vendbanimi/ Naselje	Prishtinë/ Pristina

1b. Të dhënat për Personin Juridik/ Podaci o Pravnom Licu

Emri i Personit Juridik/ Ime Pravno Lice			
Nr. Reg. Biznesit/ Reg. broj Biznesa	0	Nr. Fiskal/ Fiskalni broj	0

II. Aplikacioni është komplet/Aplikacija je kompletna

PO



JO

Në rast të mungesës së dokumenteve aplikanti do të dorëzojë dokumentet përkatëse brenda një periudhe prej 5 ditë pune!
 U slučaju nedostataka dokumentacije aplikant će predati dokumente u okviru perioda od 5 radnih dana!

Grurë	Hektar	0.41
Domate	Hektar	0.80
Pemë molle	Hektar	0.48
Lope qumështore	Krerë	5.00
Dele për mbarëshitim	Krerë	150.00
Dhi për mbarëshitim	Krerë	10.00

- Deklaratë:

- Konfirmoj që të gjitha të dhënat e ofruara në këtë aplikacion janë korrekte dhe unë do të ballafaqohem me pasojat ligjore në rast se të dhënat nuk janë të sakta apo mungojnë.
- I vë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe informatat për kontrollet në terren.
- Unë lejoj përdorimin e këtyre të dhënave në të gjithë regjistrat e MBPZHR dhe ESK.

- Izjava:

- Potvrdijem da svi podaci u ovoj aplikaciji su korektni i tačni i da ću snositi zakonske posledice ako su podaci netačni i neistiniti ili nedostaju.
- Ja uciniti dostupnim sve podatke i informacije za terensku kontrolu.
- Dajem saglasnost da se ovi podaci upotrebe u registre MPSRR i SOK.

Viti

dita/dan

muaji/mesec

viti/god

(Nënshkrimi i aplikantit / (personit të autorizuar)
 (Potpis aplikanta / (ovlačenog lica)

(Nënshkrimi i zyrtarit komunal)
 (Potpis optinskog slubenika)

NIF: 1050486

Faqe/Strana 1 nga/od 1

Datë/ Datum:

Figure 19. Aplikacioni për aplikim për Pagesa Direkte

Ueb faqja

Ueb faqja: Mirëmbajtja e ueb faqës së Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë Informative. Gjatë vitit 2021 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

Me poshtë mundë të shihni se si duket ueb faqja e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 20. Ueb Faqja

Auditimi i Brendshëm - AZHB

Auditimi i Brendshëm është një aktivitet i pavarur dhe profesional që i ofron menaxhmentit të organizatës siguri të arsyeshme se shpenzimi i fondeve, zhvillimi i procedurave, sistemi i monitorimit dhe qeverisja e përgjithshme bëhen në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe të bazuara në praktikat e mira ndërkombëtare.

Spektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) në kuadër të AZHB-së parashihet me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (i ndryshuar/plotësuar me Ligjin 04/L-090). SAB brenda AZHB-së është themelur në vitin 2018. Aktualisht, SAB funksionon me dy (2) persona: Drejtori i Auditimit dhe një auditore e brendshme.

Në fund të vitit 2020 SAB ka përgatitur Planin Strategjik të Auditimit për periudhën pesë vjeçare 2021-2025 si dhe Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2021 të cilat janë aprovuar në mars 2021 nga Ministri i MBPZHR-së.

Aktivitetet e SAB të kryera gjatë vitit 2021 ndahen në këto kategori:

- I. DETYRAT E AUDITIMIT
- II. DETYRAT E KONSULENCËS
- III. TË TJERA

DETYRAT E AUDITIMIT

SAB në vitin 2021 ka kryer tri (3) auditime sipas Planit Vjetor të Auditimit 2021 dhe një (1) auditim me kërkesë nga menaxhmenti respektivisht nga Ministri.

Auditimet sipas Planit Vjetor të Auditimit

Spektori i Auditimit të Brendshëm në vitin 2021 ka ekzekutuar tri (3) auditime të bazuara në Planin Vjetor të Auditimit që kanë mbuluar temat në vijim:

- ✓ Nënmasa 101.6 – Prodhimi i vezëve – PZHR 2019;

- ✓ Nënmasa 103.1 – Prodhimi i mjaltit – PZHR 2019;
- ✓ Pagesat Direkte për Bujqësi Organike – PPD 2019.

Në kuadër të këtyre auditimeve janë testuar gjithsej 49 mostra, gjegjësisht 32 mostra të aplikuesve të kontraktuar/përfitues, 8 mostra të aplikuesve të refuzuar dhe 9 mostra të aplikuesve të paprocesuar. Në tabelën në vijim është paraqitur shpërndarja e këtyre mostrave të audituara/testuara sipas secilës temë të auditimit.

Tabela1: Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet sipas Planit Vjetor

#	Tema e auditimit	Mostra të aplikuesve të kontraktuar (% e popullacionit)	Mostra të aplikuesve të refuzuar (% e popullacionit)	Mostra të aplikuesve të paprocesuar (% e popullacionit)	Gjithsej
1	Prodhimi i vezëve – PZHR 2019	4 (57%)	3 (43%)	4 (100%)	11
2	Prodhimi i mjaltit – PZHR 2019	11 (15.7%)	5 (11.6%)	5 (6.5%)	21
3	Pagesat Direkte për Bujqësi Organike – PPD 2019	17 (65%)	N/A	N/A	17
Gjithsej		32	8	9	49

Tabela 76. Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet sipas Planit Vjetor

Procedurat e testimit të mostrave kanë përfshirë testimin e kontrollit administrativ respektivisht të dokumentacionit që nga aplikimi deri në autorizimin e pagesave si dhe inspektimet e investimeve në terren.

Auditimet me kërkesë nga menaxhmeti

Sektori i Auditimit të Brendshëm në vitin 2021 ka kryer një (1) auditim me kërkesë nga menaxhmenti. Tema e auditimit me kërkesë ka qenë:

- ✓ Auditimi i listës së caktuar të përfituesve nga PZHR 2018-2020

Në kuadër të këtij auditimi janë testuar 18 përfitues të caktuar në kërkesën për auditim. Sipas kërkesës së menaxhmentit, procedurat e testimit të mostrave për këto auditime kanë përfshirë testimin e të gjitha fazave që nga aplikimi deri në ekzekutimin e pagesave. Procesi i ekzekutimit të pagesave, ndonëse është përfshirë në raport, nuk është audituar/testuar nga auditimi i brendshëm i AZHB-së por nga auditimi i brendshëm i MBPZHR-së sepse (sipas kërkesës) ka qenë auditim i përbashkët.

DETYRAT E KONSULENCËS

Krahas detyrave të auditimit sipas Planit Vjetor dhe bazuar në kërkesën e menaxhmentit, SAB gjatë tërë vitit 2021 ka ofruar edhe shërbime të konsulencës për menaxhmentin e lartë dhe stafin e AZHB-së.

TË TJERA

Aktivitetet tjera të kryera gjatë vitit 2021 nga ana e SAB përfshijnë:

- ✓ Koordinimi i auditimit të jashtëm/Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- ✓ Asistencë për përgatitjen e Planit të Veprimit për Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- ✓ Përgatitja e Planit Strategjik 2022-2026 dhe Planit Vjetor të Auditimit 2022.